

**UNIVERSITETI PUBLIK “KADRI ZEKA” GJILAN**  
**FAKULTETI EDUKIMIT**



**TEZA MASTER**

**Tema: Ndikimi i ambientit familjar në formimin e personalitetit të fëmijës.**

**Mentor:**

Prof. Asoc.Dr. Nerxhivane Krasniqi

**Kandidatja:**

Diana Ahmeti

Gjilan, Mars 2025

**UNIVERSITETI PUBLIK “KADRI ZEKA” GJILAN**  
**FAKULTETI EDUKIMIT**



**PUNIM DIPLOME MASTER**

|                            |                                                                       |
|----------------------------|-----------------------------------------------------------------------|
| <b>Titulli</b>             | Ndikimi i ambientit familjar në formimin e personalitetit të fëmijës. |
| <b>Emri dhe mbiemri</b>    | Diana (Sabri) Ahmeti                                                  |
| <b>Statusi i studentit</b> | E rregullt                                                            |
| <b>Numri i ID</b>          | 23151025                                                              |
| <b>Niveli i studimeve</b>  | Master                                                                |
| <b>Programi i studimit</b> | Mësimdhënia dhe kurrikula në arsimin fillor                           |
| <b>Mentori i punimit</b>   | Prof.Asoc. Dr. Nerxhivane Krasniqi                                    |

Gjilan, Mars 2025

## DEKLARATA E AUTORSISË

Nën përgjegjësinë time të plotë deklaroj se ky punim me titull **“Ndikimi i ambientit familjar në formimin e personalitetit të fëmijës”** është shkruar prej meje, nuk është prezantuar asnjëherë para një institucioni tjetër për vlerësim dhe nuk është botuar i tëri ose pjesë të veçanta të tij. Punimi nuk përmban material të shkruar nga ndonjë person tjetër përveç rasteve të cituara dhe referuara.

---

Diana Ahmeti

## MIRËNJOHJE/FALËNDERIME

Kjo temë diplome nuk do të ishte e mundur pa informacione dhe fakte të rëndësishme të marra nga studiues dhe burime që kanë hulumtuar gjerësisht mbi ndikimin e ambientit familjar në formimin e personalitetit të fëmijës dhe për këtë, unë si autore e kësaj teme i pranoj dhe i vlerësoj kontributet e tyre në këtë fushë.

Me një mirënjohje të thellë, dua të shpreh falënderimet e mia të sinqerta ndaj të gjithë atyre që më kanë ndihmuar dhe mbështetur në realizimin e kësaj teme diplome. Së pari, dua të falënderoj mentoren time, Prof.Asoc. Dr. Nerxhivane Krasniqi për udhëzimet, mbështetjen dhe këshillat gjatë gjithë procesit të hulumtimit dhe shkrimit të kësaj pune. Pa udhëzimet dhe mbështetjen e saj, kjo temë do të ishte shumë më e vështirë për t'u realizuar. Gjithashtu, falënderoj të gjithë profesorët dhe lektorët e Fakultetit të Edukimit të Universitetit Publik “Kadri Zeka” në Gjiilan, për mësimet dhe njohuritë që më kanë dhënë gjatë gjithë këtyre viteve të studimit. Njohuritë dhe përvojat e tyre kanë luajtur një rol të rëndësishëm në zhvillimin tim akademik dhe profesional.

Një falënderim i veçantë shkon për familjen time për mbështetjen e pakushtëzuar dhe inkurajimin e vazhdueshëm. Pa dashurinë dhe mbështetjen e tyre, arritjet e mia nuk do të ishin të mundura. Së fundi, dua të falënderoj të gjithë miqtë dhe kolegët e mi për ndihmën dhe mbështetjen e tyre morale gjatë gjithë kësaj periudhe. Mbështetja e tyre ka qenë një burim i madh force dhe motivimi për mua.

Me shumë respekt,

Diana Ahmeti

## **ABSTRAKT**

Ambientit familjar ka rol shumë të rëndësishëm në formimin e personalitetit të fëmijës, duke ndikuar në zhvillimin e tij emocional, kognitiv dhe social. Familja është mjedisi i parë ku fëmija fiton përvojat e para të jetës dhe ndërton bazat e identitetit të tij. Në këtë studim, analizohet ndikimi i faktorëve familjarë në formimin e personalitetit të fëmijëve, duke u fokusuar në stilet e prindërimit, marrëdhëniet prind-fëmijë, faktorët socio-ekonomikë dhe përvojat e hershme të fëmijës. Një nga aspektet më të rëndësishme të edukimit prindëror është stili i prindërimit, i cili përcakton mënyrën se si fëmija zhvillon vetëbesimin, pavarësinë dhe aftësinë për të krijuar marrëdhënie të shëndetshme me të tjerët. Studimet tregojnë se prindërit autoritativë, të cilët kombinojnë dashurinë me disiplinën, kanë më shumë gjasa të rrisin fëmijë të pavarur dhe të suksesshëm. Nga ana tjetër, prindërimi autoritar mund të shkaktojë frikë dhe pasiguri te fëmijët, ndërsa prindërimi permisiv shpesh çon në mungesë të vetëkontrollit dhe disiplinës.

Në këtë studim janë përdorur metoda kërkimore cilësore dhe sasiore për të analizuar ndikimin e ambientit familjar në formimin e personalitetit të fëmijëve. Përmes një pyetësi të zhvilluar me nxënës nga tri shkolla fillore në komunën e Gjilanit, janë mbledhur të dhëna që tregojnë ndikimin e faktorëve të ndryshëm në zhvillimin e tyre psikologjik dhe social. Rezultatet tregojnë se fëmijët që rriten në një ambient mbështetës dhe të strukturuar kanë zhvillim më të shëndetshëm të personalitetit krahasuar me ata që përballen me konflikte familjare ose mungesë vëmendjeje prindërore.

**Fjalët kyçe:** Fëmijë, Prindërit, Ambient Familjar

## **ABSTRACT**

The family environment plays a very important role in shaping a child's personality, influencing their emotional, cognitive and social development. The family is the first environment where a child gains their first life experiences and builds the foundations of their identity. This study analyzes the influence of family factors on the formation of children's personalities, focusing on parenting styles, parent-child relationships, socio-economic factors and the child's early experiences. One of the most important aspects of parental education is parenting style, which determines how a child develops self-confidence, independence and the ability to create healthy relationships with others. Studies show that authoritative parents, who combine love with discipline, are more likely to raise independent and successful children. On the other hand, authoritarian parenting can cause fear and insecurity in children, while permissive parenting often leads to a lack of self-control and discipline.

This study used qualitative and quantitative research methods to analyze the influence of the family environment on the formation of children's personalities. Through a questionnaire developed with students from three primary schools in the municipality of Gjilan, data were collected that show the impact of various factors on their psychological and social development. The results show that children who grow up in a supportive and structured environment have healthier personality development compared to those who face family conflicts or lack of parental attention.

**Keywords:** Children, Parents, Family Environme

## LISTA E GRAFIKONËVE

- **Grafiku I** – Si ndihesh kur je në shtëpi me familjen tënde?
- **Grafiku II:** A të ndihmojnë prindërit të ndihesh i/e sigurt dhe i/e besueshëm/e në vetvete?
- **Grafiku III:** Si veprojnë prindërit kur bën diçka gabim?
- **Grafiku IV:** A të lejojnë prindërit të marrësh vendime të vogla për veten tënde?
- **Grafiku V:** A të inkurajojnë prindërit që të kryesh detyrat e shkollës dhe punët e shtëpisë vetë?
- **Grafiku VI:** A ndikon gjendja ekonomike e familjes në gjërat që mund të bësh në shkollë dhe jashtë saj?
- **Grafiku VII** - Si veprojnë prindërit kur ke një problem ose ndihesh i/e mërzitur?
- **Grafiku VIII-** Si të ndihmojnë prindërit të mësosh rregullat dhe të sillesh mirë?
- **Grafiku IX:** A të ndihmon familja të ndihesh i/e rëndësishëm/e dhe i/e vlerësuar?
- **Grafiku X** - Si e kalon kohën me familjen në shtëpi?
- **Grafiku XI** - Si të ndihmojnë prindërit të bëhesh më i/e pavarur?
- **Grafiku XII** - Cilat janë vlerat dhe parimet kryesore që përpiqeni t'i mësoni fëmijës suaj në familje?
- **Grafiku XIII** - Si e ndihmoni fëmijën tuaj të zhvillojë vetëbesimin dhe pavarësinë?
- **Grafiku XIV** - Si reagoni zakonisht kur fëmija juaj bën një gabim?
- **Grafiku XV** - Si e mbështetni fëmijën tuaj në shkollim dhe zhvillimin e tij akademik?
- **Grafiku XVI** - A mendoni se gjendja ekonomike e familjes ka ndikim në mundësitë dhe zhvillimin e fëmijës suaj?
- **Grafiku XVII** - Si e ndihmoni fëmijën tuaj të krijojë marrëdhënie të shëndetshme me bashkëmoshatarët dhe njerëzit e tjerë jashtë familjes?

## **FJALORI I TERMAVE**

- **ZHF** – Zhvillimi Human dhe Familjar
- **PZP** – Psikologjia e Zhvillimit të Personalitetit
- **PMF** – Përkujdesja dhe Mirëqenia Familjare
- **EZA** – Edukimi dhe Zhvillimi i hershëm i Arsytimit
- **SHP** – Sjellja dhe Harmonia Prindërore
- **MSE** – Metodatat e Studimit të Edukimit
- **PDZ** – Procesi i Diferencuar i Zhvillimit
- **MSF** – Marrëdhëniet Shoqërore dhe Familjare
- **AFZ** – Ambienti Familjar dhe Zhvillimi
- **PEM** – Përfshirja Emocionale dhe Motivimi
- **ESF** – Edukimi dhe Stabiliteti Familjar
- **FMP** – Faktori Mjedisor dhe Personaliteti
- **RFF** – Roli i Familjes në Formimin e Fëmijës
- **ZEK** – Zhvillimi Emocional dhe Kognitiv
- **SDF** – Stili Disiplinor i Familjes
- **MBF** – Mbështetja dhe Balanca Familjare
- **DIF** – Dinamika Interaktive Familjare
- **PSP** – Prindërimi si Sfidë dhe Përgjegjësi
- **FSE** – Faktori Socio-Ekonomik
- **NAF** – Ndikimi i Ambientit Familjar
- **KMF** – Kushtet Materiale të Familja

## PËRMBAJTJA

|                                                                                   |      |
|-----------------------------------------------------------------------------------|------|
| DEKLARATA E AUTORSISË .....                                                       | III  |
| MIRËNJOHJE/FALËNDERIME .....                                                      | IV   |
| ABSTRAKT .....                                                                    | V    |
| LISTA E GRAFIKONËVE .....                                                         | VII  |
| FJALORI I TERMAVE .....                                                           | VIII |
| <br>                                                                              |      |
| 1. HYRJE .....                                                                    | 1    |
| 1.1 Prezantimi i temës .....                                                      | 2    |
| 1.2 Qëllimi i studimit .....                                                      | 2    |
| 1.3 Rëndësia e studimit .....                                                     | 3    |
| <br>                                                                              |      |
| 2. RISHIKIMI I LITERATURËS .....                                                  | 4    |
| 2.1 Teoritë mbi zhvillimin e personalitetit të fëmijës.....                       | 6    |
| 2.1.1 Teoria e Erikson-it .....                                                   | 6    |
| 2.1.2 Teoria e Bowlby-t për lidhjen .....                                         | 6    |
| 2.1.3 Teoria e Socializimit të Vygotsky-t.....                                    | 7    |
| 2.1.4 Teoria e Lewin-it për Dinamikën e Grupeve .....                             | 7    |
| 2.1.5 Teoria e Bandura-s për Mësimin Social.....                                  | 8    |
| <br>                                                                              |      |
| 2.2 Roli i metodave dhe mjeteve edukative familjare në zhvillimin e fëmijës ..... | 9    |
| 2.2.1 Trajtimi i fëmijëve .....                                                   | 9    |
| 2.2.2 Mësimi përmes shembujve .....                                               | 10   |
| 2.2.3 Dashuria për ambientin që e rrethon.....                                    | 11   |
| <br>                                                                              |      |
| 2.3 Ndikimi i ambientit familjar në formimin e personalitetit të fëmijës .....    | 12   |
| 2.3.1 Faktorët socio-ekonomikë dhe ndikimi në personalitetin e fëmijës .....      | 14   |
| 2.3.2 Llojet e prindërimit .....                                                  | 16   |
| <br>                                                                              |      |
| 2.4 Studime të mëparshme dhe përfundimet kryesore .....                           | 20   |

|                                                              |    |
|--------------------------------------------------------------|----|
| 3. METODOLOGJIA E HULUMTIMIT .....                           | 21 |
| 3.1 Qasja dhe metodat e përdorura.....                       | 22 |
| 3.2 Mostra e hulumtimit.....                                 | 22 |
| 3.3 Instrumentet e mbledhjes së të dhënave.....              | 22 |
| 3.4 Procesi i mbledhjes dhe analizës së të dhënave .....     | 23 |
| 3.5 Pyetjet e hulumtimit dhe hipotezat.....                  | 24 |
| 3.6 Kufizimet e hulumtimit .....                             | 26 |
| 4. ANALIZA E TË DHËNAVE DHE REZULTATET .....                 | 27 |
| 4.1 Prezantimi i rezultateve kryesore .....                  | 27 |
| 4.3 Krahasimi i rezultateve me literaturën e shqyrtuar ..... | 48 |
| 5. PËRFUNDIMET DHE REKOMANDIMET .....                        | 50 |
| BIBLIOGRAFIA .....                                           | 55 |
| ANEKS .....                                                  | 58 |



## 1. HYRJE

Familja luan një rol kyç në jetën e fëmijës, duke ndikuar drejtpërdrejt në formimin e personalitetit të tij. Që nga lindja, fëmijët ndikohen nga marrëdhëniet brenda familjes, nga sjellja e prindërve dhe nga mjedisi emocional e social ku rriten. Përveçse ofron kujdesin bazë, familja është përgjegjëse për edukimin, transmetimin e vlerave dhe zhvillimin e karakterit të fëmijës. Në këtë kontekst, ndikimi i ambientit familjar në formimin e personalitetit të fëmijës është një çështje me rëndësi të madhe për shkencat sociale dhe edukative.

Një ambient familjar i shëndetshëm dhe mbështetës ndihmon në zhvillimin e vetëbesimit, ndjenjës së sigurisë dhe aftësive sociale të fëmijës. Prindërit që tregojnë kujdes, dashuri dhe mbështetje të vazhdueshme krijojnë një mjedis të favorshëm për zhvillimin emocional dhe intelektual të fëmijës. Nga ana tjetër, mungesa e vëmendjes prindërore, konfliktet familjare dhe kushtet e pafavorshme socio-ekonomike ndikojnë negativisht në personalitetin dhe sjelljen e fëmijës, duke ndikuar në suksesin e tij akademik dhe në marrëdhëniet sociale.

Në këtë studim, analizohen faktorët kryesorë të ambientit familjar që ndikojnë në formimin e personalitetit të fëmijës. Shqyrtohen stile të ndryshme të prindërimit dhe efektet e tyre në zhvillimin e personalitetit. Gjithashtu, trajtohet roli i faktorëve socio-ekonomikë dhe arsimorë në ndërtimin e personalitetit të fëmijëve. Përmes këtij studimi, synohet të ofrohet një analizë e thelluar mbi ndikimin që ka ambienti familjar në formimin e karakterit të fëmijës dhe të nxirren rekomandime për prindërit dhe edukatorët mbi praktikën më të mirë për rritjen dhe edukimin e fëmijëve.

Gjithashtu, rëndësia e këtij studimi qëndron në kontributin që mund të japë për përmirësimin e metodave edukative dhe politikave sociale që mbështesin familjet në rritjen e fëmijëve. Në një kohë kur ndryshimet sociale dhe teknologjike ndikojnë ndjeshëm në strukturën familjare dhe në procesin e edukimit, është e rëndësishme të kuptohet se si këta faktorë ndikojnë në zhvillimin e fëmijëve. Studimi shërben si një udhëzues për prindërit, mësuesit dhe institucionet për të kuptuar më mirë nevojat e fëmijëve dhe për të krijuar kushte më të mira për rritjen dhe edukimin e tyre.

## **1.1 Prezantimi i temës**

Familja është institucioni i parë dhe më i rëndësishëm në jetën e një fëmije, duke shërbyer si baza e parë e socializimit dhe zhvillimit të tij. Ambienti familjar përfshin marrëdhëniet ndërpersonale midis prindërve dhe fëmijëve, metodat e edukimit që përdoren, kushtet socio-ekonomike dhe vlerat kulturore që i transmetohen brezit të ri. Që nga lindja, një fëmijë ndikohet nga komunikimi, sjellja dhe qasja prindërore, të cilat përcaktojnë mënyrën se si ai do ta perceptojë botën dhe do të ndërtojë personalitetin e tij.

Hulumtimet tregojnë se ambienti familjar luan një rol të rëndësishëm në zhvillimin emocional, social dhe akademik të fëmijëve. Një ambient mbështetës dhe i dashur ndihmon në rritjen e vetëbesimit dhe pavarësisë së fëmijës, ndërsa një ambient konfliktual ose neglizhues mund të sjellë pasoja negative, si pasiguri emocionale apo vështirësi në krijimin e marrëdhënieve sociale.

## **1.2 Qëllimi i studimit**

Ky studim ka për qëllim të analizojë dhe të kuptojë më në detaje ndikimin që ambienti familjar ka në formimin e personalitetit të fëmijëve. Duke marrë në konsideratë faktorë të ndryshëm, si marrëdhëniet prindërore, metodat e edukimit, statusin socio-ekonomik dhe prirjet kulturore të familjes, synohet të kuptohet se si këto elemente ndikojnë në formimin e vetëdijes, sjelljeve dhe aftësive sociale të një fëmije.

Një ndër qëllimet kryesore të këtij studimi është të analizojë ndikimin e stileve të ndryshme të prindërimit, si prindërimi autoritar, permisiv dhe demokratik, në zhvillimin e karakterit dhe vetëbesimit të fëmijëve. Për më tepër, do të shqyrtohet se si përkrahja emocionale ose mungesa e saj mund të ndikojë në shëndetin mendor dhe stabilitetin emocional të tyre. Gjithashtu, do të vlerësohet roli i faktorëve socio-ekonomikë, duke përfshirë edukimin e prindërve dhe nivelin e të ardhurave, në mundësitë e zhvillimit të fëmijëve dhe ndërtimin e personalitetit të tyre.

### 1.3 Rëndësia e studimit

Studimi i ndikimit të ambientit familjar në formimin e personalitetit të fëmijës është i rëndësishëm për disa arsye thelbësore.

- **Së pari**, ai ndihmon në thellimin e kuptimit mbi rolin që luan familja në edukimin dhe zhvillimin emocional të fëmijës, duke ofruar një perspektivë më të qartë mbi ndikimin afatgjatë të ambientit familjar në sjelljen dhe karakterin e tij. Përmes këtij studimi, prindërit mund të marrin njohuri më të mira mbi mënyrat më efektive të rritjes dhe edukimit të fëmijëve të tyre, duke krijuar një ambient më të sigurt dhe të shëndetshëm për zhvillimin e tyre.
- **Së dyti**, ky studim është i rëndësishëm për mësuesit dhe edukatorët, pasi u mundëson atyre të kuptojnë më mirë sfidat dhe ndikimet që sjell ambienti familjar në mësimnxënien dhe sjelljen e nxënësve në shkollë. Duke qenë se shkolla është institucioni i dytë më i rëndësishëm në socializimin e një fëmije, është e rëndësishme që edukatorët të jenë të vetëdijshëm për faktorët që mund të ndikojnë në motivimin dhe angazhimin e fëmijëve në procesin mësimor.
- **Së fundmi**, studimi sjell vlerë edhe për politikëbërësit dhe institucionet arsimore e sociale, duke nxitur zhvillimin e politikave që mbështesin familjet dhe fëmijët në situata të vështira. Përmes analizës së faktorëve familjarë që ndikojnë në personalitetin e fëmijës, ky studim mund të kontribuojë në zhvillimin e programeve edukative dhe psikologjike që ndihmojnë fëmijët në përballimin e sfidave që mund të vijnë nga ambienti familjar.

Ky hulumtim do të kontribuojë në literaturën akademike dhe në praktikat arsimore, duke ndihmuar prindërit, mësuesit dhe politikëbërësit të krijojnë kushte më të mira për zhvillimin e fëmijëve dhe të ardhmen e tyre.

## 2. RISHIKIMI I LITERATURËS

Familja është një nga faktorët më të rëndësishëm në formimin e personalitetit të fëmijës dhe është një temë që ka shqetësuar studiuesit e fushës së psikologjisë dhe edukatës për shumë vite. Sipas teorisë së socializimit të Erikson (1950), fazat e hershme të zhvillimit të fëmijës, të cilat ndodhin brenda familjes, janë të rëndësishme për formimin e karakterit dhe aftësive sociale. Këto faza shoqërohen nga influenca të mëdha nga prindërit, përfshirë stilet e prindërimit, marrëdhëniet ndërpersonale dhe faktorët socio-ekonomikë. Ky rishikim i literaturës do të shqyrtojë ndikimin e ambientit familjar në zhvillimin e personalitetit të fëmijës, duke analizuar disa aspekte të rëndësishme të këtij ndikimi dhe duke diskutuar teoritë dhe kërkimet që mbështesin këtë ndikim.

Një nga konceptet më të rëndësishme për të kuptuar ndikimin e familjes është se familja është ajo që formon bazat e karakterit të fëmijës. Kjo është e dukshme që nga lindja, kur fëmija fillon të zhvillojë aftësitë sociale, emocionale dhe intelektuale. Erikson (1950) thekson se kjo periudhë e hershme është e rëndësishme për zhvillimin e vetëbesimit dhe për të ndërtuar marrëdhënie të shëndetshme me të tjerët. Fëmijët që rriten në një ambient mbështetës dhe të dashur janë më të prirur të zhvillojnë besimin në vetvete dhe aftësinë për të krijuar marrëdhënie të shëndetshme dhe të qëndrueshme në të ardhmen.

Në këtë kuadër, stili i prindërimit është një nga faktorët kryesorë që ndikon në zhvillimin e personalitetit të fëmijës. Baumrind (1966) zhvilloi një teori të njohur që identifikon katër stile të prindërimit: autoritar, autoritativ, liberal dhe indiferent. Çdo stil ka një ndikim të ndryshëm në fëmijë. Prindërit autoritarë kanë kërkesa të larta dhe mbështetje të ulët, dhe kjo shpesh çon në fëmijë që janë të nënshtruar dhe të pakënaqur, duke ndikuar në formimin e një personaliteti të paqëndrueshëm dhe me vetëbesim të ulët. Përkundrazi, prindërit autoritativë që kanë kërkesa të larta dhe mbështetje të lartë kanë një ndikim pozitiv në zhvillimin e fëmijëve, duke i ndihmuar ata të zhvillojnë aftësi sociale dhe të kenë një vetëbesim të qëndrueshëm. Këto stile prindërimi janë të lidhura ngushtë me zhvillimin emocional të fëmijës dhe formimin e personalitetit të tij (Baumrind, 1991).

Përveç ndikimit të stilit të prindërimit, faktorët socio-ekonomikë kanë gjithashtu një rol të rëndësishëm në formimin e personalitetit të fëmijës. Fëmijët që rriten në kushte socio-ekonomike të pafavorshme shpesh janë të ekspozuar ndaj stresit të shtuar dhe kushteve të vështira, që mund të kenë një ndikim negativ në zhvillimin e tyre emocional dhe social. Sipas kërkimeve të Conger et al. (1994), familjet që përballen me pasiguri financiare shpesh përjetojnë një periudhë tensioni që mund të ndikojë në marrëdhëniet brenda familjes dhe të çojë në probleme emocionale për fëmijët. Ndërsa, familjet që kanë kushte më të mira financiare dhe arsimore krijojnë mundësi më të mira për zhvillimin e fëmijëve, duke i mundësuar atyre të kenë qasje në burime dhe mundësi edukative që ndihmojnë në formimin e një personaliteti të fortë dhe të shëndetshëm (Conger et al., 1992). Studiuesit gjithashtu kanë theksuar se ndihma financiare dhe mbështetje nga shoqëria mund të ndihmojnë në minimizimin e ndikimit negativ të kushteve socio-ekonomike të pafavorshme dhe të krijojnë një mjedis më të favorshëm për fëmijën.

Një tjetër aspekt i rëndësishëm i ndikimit të ambientit familjar është marrëdhënia ndërpersonale mes prindërve dhe fëmijës. Sipas teorisë së lidhjes (attachment theory) të Bowlby (1969), fëmijët që zhvillojnë një lidhje të sigurt me prindërit e tyre kanë më shumë mundësi të zhvillojnë aftësi sociale dhe emocionale të shëndetshme. Kjo lidhje e sigurt është e nevojshme për formimin e një personaliteti të shëndetshëm dhe për të krijuar marrëdhënie të shëndetshme me të tjerët. Bowlby (1969) argumenton se fëmijët që kanë marrë një lidhje të sigurt me prindërit e tyre janë më të aftë të përballojnë sfidat e jetës dhe të zhvillojnë aftësi të shëndetshme ndërnjerëzore.

Shkolla dhe shoqëria gjithashtu luajnë një rol të rëndësishëm në zhvillimin e fëmijës, duke ndihmuar në formimin e aftësive sociale dhe akademike. Studiues të ndryshëm kanë theksuar se mjedisi shkollor dhe marrëdhëniet ndërmjet prindërve dhe mësuesve kanë ndikim të drejtpërdrejtë në zhvillimin e personalitetit të fëmijës. Epstein (2001) thekson rëndësinë e bashkëpunimit midis shkollës dhe familjes për të siguruar një mbështetje të plotë dhe të qëndrueshme për fëmijën. Ky bashkëpunim mund të kontribuojë në zhvillimin e aftësive sociale dhe emocionale të fëmijës, duke ndihmuar në krijimin e një personaliteti të balancuar dhe të shëndetshëm.

## **2.1 Teoritë mbi zhvillimin e personalitetit të fëmijës**

Zhvillimi i personalitetit të fëmijës është një proces kompleks që përfshin ndërveprimet e ndryshme midis faktorëve biologjikë, mjedisorë dhe socialë. Teoritë psikologjike kanë luajtur një rol të rëndësishëm në kuptimin e këtij zhvillimi dhe ndikimit që kanë elementë të ndryshëm të ambientit në formimin e personalitetit. Këtu, do të shqyrtojmë disa nga teoritë më të njohura që ndihmojnë në kuptimin e zhvillimit të personalitetit të fëmijës.

### **2.1.1 Teoria e Erikson-it**

Erik Erikson ka zhvilluar një teori të njohur të zhvillimit të personalitetit të fëmijës, e cila përfshin tetë faza të zhvillimit gjatë gjithë jetës. Sipas Erikson-it, zhvillimi i personalitetit është një proces i pandërprerë që vazhdon përmes çdo faze të jetës. Çdo fazë ka një çështje kyçe që individi duhet ta zgjidhë për të arritur zhvillim emocional të shëndetshëm. Për shembull, gjatë fëmijërisë, fëmijët duhet të zhvillojnë besimin në vetvete dhe të merren me ndjenjat e tyre të sigurisë dhe pasigurisë. Erikson-i thekson se ndikimi i mjedisit, sidomos i familjes, është i rëndësishëm në këtë proces, pasi ai mund të sigurojë një mbështetje të nevojshme për zhvillimin e vetëbesimit dhe të identitetit të fëmijës (Erikson, 1950).

### **2.1.2 Teoria e Bowlby-t për lidhjen**

John Bowlby, një tjetër studiues i njohur, zhvilloi teorinë e lidhjes, e cila fokusohet në rëndësinë e marrëdhënieve të hershme ndërmjet fëmijës dhe kujdestarëve të tij, zakonisht prindërve. Bowlby thekson se lidhja e sigurt midis fëmijës dhe prindërve është thelbësore për zhvillimin e personalitetit të shëndetshëm, pasi ajo krijon bazat e besimit dhe të sigurisë emocionale për fëmijën. Fëmijët që zhvillojnë një lidhje të sigurt janë më të prirur të zhvillojnë aftësi sociale të shëndetshme dhe të krijojnë marrëdhënie të qëndrueshme me të tjerët gjatë jetës (Bowlby, 1969). Teoria e lidhjes ka ndikim të madh në fushën e edukatës dhe kujdesit për fëmijët, duke treguar se ndihma dhe mbështetja që prindërit ofrojnë gjatë fëmijërisë janë të domosdoshme për zhvillimin emocional të fëmijës.

### **2.1.3 Teoria e Socializimit të Vygotsky-t**

Lev Vygotsky, një psikolog rus, e ndihmoi zhvillimin e konceptit të socializimit dhe ndikimin e mjedisit social në zhvillimin e fëmijës. Ai theksoi rolin e rëndësishëm që ka bashkëpunimi me të tjerët në formimin e aftësive intelektuale dhe sociale të fëmijës. Vygotsky-i besonte se zhvillimi intelektual është i lidhur ngushtë me interaksionet shoqërore dhe se fëmijët zhvillojnë njohuri dhe aftësi përmes ndërveprimeve me individë më të aftë, si prindërit ose mësuesit. Ai e përshkroi konceptin e "zona e zhvillimit të mundshëm" (ZDM), që tregon se fëmijët mund të arrijnë nivele më të larta të zhvillimit kur punojnë me individë që kanë më shumë njohuri dhe aftësi (Vygotsky, 1978). Kjo teori thekson rëndësinë e mbështetjes sociale në zhvillimin e personalitetit të fëmijës, si dhe ndikimin e faktorëve të jashtëm në këtë proces.

### **2.1.4 Teoria e Lewin-it për Dinamikën e Grupeve**

Kurt Lewin është një tjetër studiues që ka kontribuar në kuptimin e zhvillimit të personalitetit, duke e lidhur atë me ndikimin e grupit dhe të shoqërisë. Lewin-i besonte se individët zhvillohen dhe formojnë personalitetin e tyre përmes ndërveprimeve sociale dhe se kjo është e lidhur ngushtë me rregullat dhe normat e grupit. Për fëmijët, familja dhe shoqëria janë dy faktorët kryesorë që formojnë këto ndërveprime dhe ndikojnë drejtpërdrejt në zhvillimin e personalitetit të tyre. Lewin-i theksoi se grupet sociale, të tilla si grupi i fëmijëve ose shoqëria e klasës, mund të ushtrojnë një ndikim të fortë në sjelljen dhe formimin e vlerave të fëmijës (Lewin, 1935). Kjo teori tregon se zhvillimi i personalitetit të fëmijës nuk ndodh vetëm brenda familjes, por edhe në ndërveprimet me grupet sociale të jashtme.

### **2.1.5 Teoria e Bandura-s për Mësimin Social**

Albert Bandura zhvilloi teorinë e mëimit social, e cila fokusohet në rolin e modeleve dhe imazheve që fëmijët shohin dhe ndjekin. Sipas Bandura-s, fëmijët mësojnë përmes vëzhgimit të sjelljes së të tjerëve dhe modelimit të sjelljeve që ata shohin si të suksesshme ose të përshtatshme. Bandura theksoi se procesi i mëimit social ka një ndikim të rëndësishëm në zhvillimin e personalitetit të fëmijës, pasi sjelljet dhe ndjenjat që fëmijët mësojnë nga figura të tilla si prindërit, mësuesit dhe shokët e tyre mund të formojnë vlera dhe normat që ata do të zhvillojnë në jetë (Bandura, 1977). Kjo teori është thelbësore për kuptimin e ndikimit të faktorëve socialë dhe mjedisorë në formimin e personalitetit të fëmijës.

Teoritë që janë diskutuar, përfshirë ato të Erikson-it, Bowlby-t, Vygotsky-t, Lewin-it dhe Bandura-s, kanë dhënë kontribute të mëdha në kuptimin e zhvillimit të personalitetit të fëmijës. Çdo teori ka nxjerrë në pah aspekte të ndryshme të zhvillimit, duke theksuar rolin e familjes, shoqërisë dhe mjedisit në këtë proces. Një aspekt i rëndësishëm që del nga këto teoritë është se zhvillimi i personalitetit të fëmijës është një proces i ndërvarur, që ka nevojë për mbështetje dhe ndërveprime pozitive nga mjedisi social dhe familjar. Këto ndikime janë të rëndësishme për ndihmën që fëmijët të zhvillojnë aftësitë e nevojshme për të jetuar një jetë të shëndetshme dhe të suksesshme.

## **2.2 Roli i metodave dhe mjeteve edukative familjare në zhvillimin e fëmijës**

Edukimi i fëmijëve është një proces kompleks që përfshin metoda dhe mjete të veçanta me qëllim arritjen e një formimi të drejtë dhe të qëndrueshëm. Familja, si institucioni i parë edukativ dhe shoqëror për fëmijën, luan një rol kyç në këtë proces. Në fushën shkencore, termi "metodë" i referohet mënyrës së studimit dhe njohjes së ligjshmërive të ndryshme, ndërsa në filozofi lidhet me teorinë e parimeve që ndihmojnë në kuptimin dhe transformimin e jetës shoqërore. Meqenëse edukimi i fëmijës bazohet në të dhëna shkencore nga fusha të tilla si psikologjia dhe pedagogjia, ai synon ta përgatisë atë për jetë dhe për integrimin në grupe shoqërore. Ky proces nuk mund të realizohet pa përdorimin e metodave dhe mjeteve të përshtatshme, të cilat ndihmojnë në zhvillimin e pavarësisë së fëmijës pa e kufizuar atë.

Për të arritur qëllimet e paracaktuara në edukimin familjar, është e rëndësishme të identifikohen metodat më efikase, të cilat ndryshojnë nga ato që përdoren në shkolla apo institucione të tjera arsimore. Ndërsa shkollat dhe mësimdhënësit ndjekin strategji të përcaktuara për një edukim më të gjerë dhe formal, familja përdor qasje më të personalizuar, të cilat ndikojnë drejtpërdrejt në formimin e vlerave, sjelljeve dhe qëndrimeve të fëmijës (Dolito, 2001).

### **2.2.1 Trajtimi i fëmijëve**

Në shoqërinë tonë, rastet kur fëmijët trajtohen me respekt nga prindërit, mësuesit apo të rriturit e tjerë janë ende të kufizuara. Shpeshherë, komunikimi me ta nuk zhvillohet në një mënyrë të barabartë, sikur të ishin individë me vetëdije dhe arsytim, ndonëse një qasje e tillë do të duhej të ishte e pranishme në çdo marrëdhënie edukative. Mënyra se si i flasim një fëmije pasqyron jo vetëm karakterin tonë, por edhe modelin që ai do të ndjekë në të ardhmen në raport me të tjerët. Shpesh, në mënyrë të pavetëdijshme, të rriturit u drejtohen fëmijëve me tone urdhëruese, duke përdorur shprehje të tilla si: "Futu në makinë!", "Laji duart!", "Ha drekën!" etj. Nga ana tjetër, kur presim që ata të jenë të sjellshëm dhe të përdorin shprehje si "Ju lutem", "Faleminderit" apo "A mundem?", shpesh nuk marrim rezultatin e dëshiruar. Kjo ndodh sepse fëmijët mësojnë kryesisht nga shembulli dhe jo nga urdhrat. Nëse nuk u ofrohet modeli i duhur në komunikim, ata nuk kanë nga ta mësojnë respektin dhe mirësjelljen (Boere, 2004).

Një pyetje e rëndësishme që duhet të shtrojmë është: Pse fëmijët pritet të ndjekin çdo urdhër pa diskutim, kur diçka e tillë nuk kërkohet nga një i rritur? Kjo qasje shpesh tregon mungesë respekti ndaj fëmijëve si individë të barasvlefshëm. Fëmijët, ashtu si çdo qenie tjetër njerëzore, meritojnë respekt. Mirëpo, respekti nuk mund të pritët prej tyre nëse fillimisht nuk u shprehet nga të rriturit (Templar, 2013). Në librin e tij *The Rules of Parenting*, autori R. Templar thekson se një nga rregullat kryesore të prindërimit është trajtimi i fëmijëve me respekt. Ai thekson se, nëse prindërit i duan fëmijët e tyre më shumë se çdo person tjetër (përveç bashkëshortit/es), atëherë ata meritojnë respektin më të madh dhe jo më pak (Garuli, 2017). Në edukimin familjar, është e domosdoshme që fillimisht të përcaktohet qartë qëllimi i edukimit, pastaj të zgjidhen metodat dhe mjetet më të përshtatshme për ta arritur atë. Pa një qëllim të qartë, nuk mund të ketë as metoda efektive dhe as rezultate të dëshiruara në edukimin e fëmijës (Hoti, 2012).

### 2.2.2 Mësimi përmes shembujve

Shumë autorë të fushës së edukimit dhe zhvillimit të fëmijëve kanë theksuar se ndikimi më i madh në formimin e tyre vjen nga modeli që ata shohin tek të rriturit përreth. Duke marrë parasysh se në moshën e hershme fëmijët mësojnë kryesisht përmes konkretizimit, sjelljet dhe veprimet tona në praninë e tyre janë shembulli më i drejtpërdrejtë dhe më ndikues që ata ndjekin (Gjika, 2018). Një shembull ilustrues vjen nga Dr. Maria Montessori: "Një ditë pashë një fëmijë rreth dy vjeç që vendosi një palë këpucë të ndotura mbi një çarçaf të bardhë. Pa u menduar gjatë, i mora këpucët dhe i vendosa në një qoshe të dhomës, duke thënë: 'Ato janë të papastra'. Më pas, me duar pastrova vendin ku ishin vendosur këpucët. Pas këtij momenti, sa herë që fëmija shihte këpucë, vraponte drejt tyre dhe përsëriste: 'Ato janë të papastra'. Më pas, afrohej te shtrati dhe bënte sikur po pastronte, edhe pse këpucët nuk ishin më aty" (Montessori, 2009).

Ky shembull tregon qartë se fëmijët nuk arrijnë të kuptojnë një mesazh vetëm nga fjalët tona, por më së shumti nga mënyra si veprojmë. Edhe nëse synimi ishte që fëmija të mësohej të mbante pastër dhe të mos vendoste këpucë mbi çarçaf, mënyra se si i rrituri veproji u bë modeli që fëmija ndoqi, duke përsëritur sjelljen në të njëjtën formë. Për këtë arsye, është e rëndësishme që të rriturit të jenë të vetëdijshëm për shembullin që japin, pasi fëmijët mësojnë kryesisht duke imituar ata që i rrethojnë.

### 2.2.3 Dashuria për ambientin që e rrethon

Njeriu ka një prirje natyrore për t'u kujdesur për mjedisin që e rrethon. Kur bëhet fjalë për ambientin ku rritet një fëmijë, është e rëndësishme të kemi parasysh se ai përfshin jo vetëm hapësirën fizike, por edhe marrëdhëniet me prindërit, motrat, vëllezërit dhe të tjerët përreth tij. Këta faktorë luajnë një rol kyç në edukimin dhe zhvillimin e tij. Fëmijët mësojnë shkathtësi jetësore dhe forma sjelljeje nga mjedisi në të cilin ekspozohen për herë të parë. Sjellja e të rriturve, veçanërisht e prindërve, ka një ndikim të pashmangshëm në mënyrën se si fëmija percepton botën dhe ndërton qëndrimet e tij. Një ambient i qetë në shtëpi, lëvizjet e buta dhe një komunikim i kujdesshëm krijojnë ndjenja sigurie dhe qetësie te fëmija. Nëse të rriturit sillen me qetësi dhe kujdes në përditshmërinë e tyre, fëmija do ta marrë këtë model si mënyrë të natyrshme të veprimit.

Marrëdhëniet mes të rriturve, veçanërisht prindërve, reflektohen drejtpërdrejt te fëmijët. Çdo prind ka mënyrën e tij të menaxhimit dhe edukimit të fëmijës, dhe kjo qasje duhet të jetë në përputhje me emocionet dhe mirëqenien e tyre. Përjetimi i prindërimit nuk duhet parë vetëm si një detyrë, por si një përvojë e kënaqshme, pasi fëmija është i ndjeshëm ndaj emocioneve të prindërve. Ai do të ndiejë nëse prindërit i afrohen me dashuri dhe qetësi apo, përkundrazi, me nervozizëm dhe stres. Siç thekson Templar (2013): "Në fund të fundit, disponimi juaj është po aq i rëndësishëm sa strategjia e rritjes së fëmijës dhe mënyra se si jetoni si familje – ndoshta edhe më shumë. Mos lejoni që dikush t'ju bëjë të ndiheni fajtorë për mënyrën si veproni. Nëse një metodë ju bën të ndiheni më rahat dhe më pak të stresuar, atëherë ndoshta është rruga më e mirë për ju dhe familjen tuaj."

## 2.3 Ndikimi i ambientit familjar në formimin e personalitetit të fëmijës

Ambientet ku fëmijët rriten dhe zhvillohen kanë një ndikim të thellë në formimin e personalitetit të tyre. Familja është një nga faktorët më të rëndësishëm që ndikon në zhvillimin e individëve, veçanërisht gjatë fazave të hershme të jetës. Duke u bazuar në teoritë e zhvillimit psikologjik dhe kërkimet shkencore, është e qartë se prindërit dhe anëtarët e tjerë të familjes luajnë një rol të rëndësishëm në krijimin e personalitetit të fëmijës, duke ofruar mbështetje emocionale, modele sjelljesh, dhe mundësi për të mësuar rreth normave dhe vlerave sociale.

Prindërit janë aktorët kryesorë që ndihmojnë në formimin e personalitetit të fëmijës. Sipas teorisë së Bowlby-t për lidhjen (1969), lidhjet e hershme emocionale të fëmijës me kujdestarët e tij janë thelbësore për zhvillimin e sigurisë emocionale. Kur një fëmijë rritet në një mjedis ku ndihet i sigurt dhe i mbrojtur nga prindërit e tij, ai zhvillon një besim të fortë në vetvete dhe në botën që e rrethon. Ky besim është një nga ndihmuesit kryesorë në zhvillimin e personalitetit të fëmijës, pasi ai mundëson që fëmija të zhvillojë aftësi sociale dhe emocionale të shëndetshme (Bowlby, 1969).

Një aspekt tjetër që ndikon në zhvillimin e personalitetit është stili i kujdesit të prindërve. Diana Baumrind (1967) ka identifikuar katër stile të kujdesit prindëror: autoritar, autorativ, lehtësues dhe indiferent. Prindërit autorativë, të cilët ofrojnë mbështetje dhe kufizime të qarta, zakonisht rrisin fëmijë të cilët kanë personalitete të shëndetshme dhe aftësi të mira për t'u përshtatur në situata sociale. Në anën tjetër, prindërit autoritarë, të cilët vendosin rregulla të ashpra dhe janë më të pakët në mbështetje emocionale, mund të kontribuojnë në zhvillimin e fëmijëve që ndjehen të frikësuar ose të pasigurt. Ky ndryshim i stilit të kujdesit ka ndikim të drejtpërdrejtë në mënyrën se si fëmijët krijojnë besim në vetvete dhe marrëdhënie me të tjerët (Baumrind, 1967).

Ambientet familjare të mbushura me mbështetje dhe komunikim të hapur janë kritike për zhvillimin e aftësive sociale dhe emocionale të fëmijës. Sipas teorisë së Vygotsky-t (1978), fëmijët mësojnë përmes ndërveprimeve me individë më të aftë, përfshirë prindërit dhe kujdestarët. Kur prindërit krijojnë mundësi për biseda dhe aktivitete që stimulojnë zhvillimin emocional dhe intelektual, ata ndihmojnë në formimin e aftësive që fëmijët do të përdorin për të krijuar marrëdhënie të shëndetshme dhe për t'u përshtatur me kërkesat e mjedisit shoqëror.

Një aspekt tjetër është ndihma që fëmijët marrin për t'u mësuar të kontrollojnë emocionet e tyre dhe të ndërveprojnë në mënyra të shëndetshme me të tjerët. Fëmijët që rriten në një mjedis ku ata ndihen të kuptuar dhe të mbështetur janë më të prirur të zhvillojnë aftësi të mira për të përballuar stresin dhe për të menaxhuar emocionet e tyre në mënyrë të efektshme. Ky tipar është i rëndësishëm për formimin e personalitetit të fëmijës, pasi individët që kanë aftësi të shëndetshme për menaxhimin e emocioneve janë më të aftë të krijojnë marrëdhënie të qëndrueshme dhe të përballojnë vështirësitë e jetës (Erikson, 1950).

Konfliktet në familje, përkundrazi, mund të kenë ndikime negative në zhvillimin e personalitetit të fëmijës. Sipas një studimi të realizuar nga Cummings et al. (2000), fëmijët që rriten në mjedise ku ka tensione dhe konflikte të vazhdueshme mund të zhvillojnë probleme të natyrës emocionale dhe sociale, si pasiguri, frikë dhe agresivitet. Këto probleme mund të ndikojnë në mënyrën se si ata ndërveprojnë me të tjerët dhe zhvillojnë strategji për të menaxhuar ndjenjat e tyre. Disa fëmijë mund të zhvillojnë shqetësime të natyrës sociale, të tilla si vështirësi në krijimin e lidhjeve pozitive me bashkëmoshatarët, duke pasur pasojë të drejtpërdrejtë në formimin e personalitetit të tyre.

Për më tepër, kërkimet kanë treguar se ndikimi i prindërve mbi fëmijët mund të jetë i ndryshëm në varësi të kushteve socio-ekonomike të familjes. Fëmijët që rriten në familje me kushte të vështira socio-ekonomike mund të përjetojnë më shumë stres dhe pasiguri, gjë që mund të ndikojë negativisht në zhvillimin e personalitetit të tyre. Prindërit që janë të ngarkuar me shqetësime financiare ose probleme të tjera të jetës mund të kenë vështirësi në ofrimin e një mjedisi emocional të qëndrueshëm dhe të mbështetur për fëmijët e tyre (Conger et al., 1992).

### **2.3.1 Faktorët socio-ekonomikë dhe ndikimi në personalitetin e fëmijës**

Faktorët socio-ekonomikë janë një grup faktorësh që ndikojnë drejtpërdrejt në zhvillimin e personalitetit të fëmijëve dhe në formimin e aftësive të tyre sociale, emocionale dhe intelektuale. Këta faktorë përfshijnë kushte ekonomike, statusin social të familjes, arsimimin e prindërve, si dhe mundësitë e aksesit në burime të ndryshme edukative dhe sociale. Shumë studime kanë treguar se një mjedis socio-ekonomik më i mirë mund të ndihmojë në zhvillimin e fëmijëve, ndërsa një mjedis më i varfër mund të sjellë sfida të konsiderueshme që ndikon në personalitetin e tyre.

Një nga faktorët kryesorë që ndikon në zhvillimin e fëmijës është statusi ekonomik i familjes. Familjet me të ardhura të ulëta shpesh përballen me sfida të shumta, të tilla si mungesa e aksesit në kujdes shëndetësor cilësor, mundësitë e kufizuara për aktivitete edukative dhe sociale, dhe kushte të vështira jetese. Këto kushte mund të ndikojnë negativisht në zhvillimin e personalitetit të fëmijëve. Fëmijët që rriten në kushte ekonomike të vështira shpesh mund të ndjehen të pasigurt, të frikësuar, dhe të kenë nivele të larta stresi, të cilat mund të çojnë në zhvillimin e problemeve emocionale dhe sociale (Conger et al., 1992).

Studimet kanë treguar se fëmijët që jetojnë në familje me kushte të vështira socio-ekonomike shpesh kanë aftësi të kufizuara për të zhvilluar mendimin kritik dhe aftësitë sociale. Këto fëmijë janë më të prirur të zhvillojnë ndjenja të pafuqishmërisë dhe kanë vështirësi në përballimin e presioneve sociale dhe emocionale. Në të kundërt, fëmijët që rriten në familje më të pasura dhe të stabilizuara ekonomikisht kanë mundësi më të mira për të zhvilluar aftësi të shëndetshme sociale dhe intelektuale, si dhe për të zhvilluar besim të fortë në vetvete (Huston et al., 2005).

Një tjetër faktor socio-ekonomik që ka ndikim të rëndësishëm në zhvillimin e personalitetit të fëmijës është niveli i edukimit të prindërve. Prindërit që kanë një arsim të lartë kanë më shumë mundësi për t'u angazhuar në aktivitete edukative që ndihmojnë në zhvillimin kognitiv dhe emocional të fëmijëve të tyre. Ata gjithashtu kanë mundësi të ofrojnë një mjedis stimulues, që është kyç për rritjen e aftësive intelektuale dhe të personalitetit të fëmijës (Lareau, 2003).

Fëmijët që rriten në familje me prindër më të edukuar shpesh kanë më shumë mundësi për të mësuar dhe zhvilluar aftësi të shëndetshme sociale. Prindërit që janë të arsimuar janë më të aftë të komunikojnë në mënyrë efektive me fëmijët e tyre dhe t'u ofrojnë mbështetje të duhur për të mësuar si të përballen me sfidat e jetës. Ky lloj mbështetjeje ndihmon në zhvillimin e personalitetit të fëmijës dhe në formimin e besimit të vetë-vlerësimit, të cilat janë kritike për suksesin në jetën sociale dhe profesionale (Belsky, 1984).

Përveç kushteve ekonomike të familjes, mjedisi shkollor është një tjetër faktor kyç që ndikon në formimin e personalitetit të fëmijës. Fëmijët që rriten në familje me kushte të vështira socio-ekonomike shpesh kanë vështirësi në aksesin e mundësive edukative cilësore. Ata mund të shkollohen në shkolla me burime të kufizuara, mësues të paqëndrueshëm dhe mundësi të pakta për aktivitete jashtëshkollore. Ky lloj mjedisi mund të kufizojë zhvillimin e aftësive sociale dhe emocionale të fëmijëve, duke i bërë ata më të pasigurt dhe më të ndjeshëm ndaj problemeve të jetës (Evans, 2004).

Në të kundërt, fëmijët që kanë mundësi të aksesojnë shkolla me burime të pasura, mësues të kualifikuar dhe aktivitete edukative të pasura, kanë mundësi më të mëdha për t'u zhvilluar si individë të suksesshëm dhe të shëndetshëm emocionalisht. Ky lloj mjedisi ofron mundësi për të mësuar aftësi të reja, për t'u angazhuar në ndërveprime pozitive me bashkëmoshatarët dhe për të zhvilluar personalitete të forta dhe të qëndrueshme (McLoyd, 1998)

### 2.3.2 Llojet e prindërimit

Qenia njerëzore trashëgon një strukturë biologjike dhe gjenetike të përcaktuar, të cilën e merr kryesisht nga prindërit. Prindërit luajnë rolin e kujdestarëve të fëmijëve të tyre, pavarësisht nëse ata janë ende në varësi të plotë apo tashmë të rritur. Përgjegjësia e tyre shtrihet jo vetëm në aspektin moral, por edhe ligjor, deri në momentin kur fëmija konsiderohet i pavarur, sipas ligjeve në fuqi. Sipas Konventës mbi të Drejtat e Fëmijëve, e miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e OKB-së më 20 nëntor 1989, çdo individ nën moshën 18 vjeç konsiderohet fëmijë, përveç rasteve kur ligjet vendore përcaktojnë ndryshe (Sideris, 2010).

Është e rëndësishme të theksohet se prindërimi nuk kufizohet vetëm në lidhjen biologjike. Prind mund të bëhet dikush edhe përmes adoptimit apo përmes metodave të avancuara të fekondimit artificial. Pavarësisht mënyrës së ardhjes në jetë, përgjegjësia dhe përkushtimi prindëror mbeten të njëjta, duke përfshirë detyrimet morale dhe ligjore ndaj rritjes dhe edukimit të fëmijës. Siç thekson Sideris (2010), prania e prindërve dhe përkushtimi i tyre është thelbësor për mirëqenien e fëmijës.

Prindërimi në shoqërinë e sotme është një sfidë komplekse dhe dinamike. Përveç vështirësive si heqja dorë nga liria individuale dhe përballja me përgjegjësitë e reja, prindërit përjetojnë një proces të vazhdueshëm të mësimi dhe përshtatjes. Dashuria dhe dëshira për të pasur fëmijë janë thelbësore, por nuk janë të mjaftueshme. Edukimi i prindërve dhe aftësia e tyre për të krijuar një mjedis të qëndrueshëm e të shëndetshëm emocionalisht luan një rol vendimtar. Kur prindërit janë të vetëdijshëm për ndikimin e tyre në zhvillimin e fëmijës dhe përcaktojnë qëllime të qarta për edukimin e tij, ata kontribuojnë në formimin e një individi të aftë për shoqërinë e ardhshme.

Sipas psikanalistit dhe pedagogut Dr. Nikos Sideris (2010), roli i prindit është po aq i rëndësishëm sa nevojat bazike për mbijetesë, si ushqimi dhe uji. Fëmijët kanë nevojë të pazëvendësueshme për prindërit e tyre, dhe mënyra se si ata e përmbushin këtë rol ndikon drejtpërdrejt në formimin e personalitetit dhe stabilitetin emocional të fëmijës. Maturia emocionale dhe pedagogjike e prindërve reflektohet në vendimet dhe sjelljen e tyre, duke ndikuar në disiplinën, sigurinë dhe besimin e fëmijës. Në të kundërt, një prindërim i pasigurt mund të sjellë pasoja negative si mungesa e disiplinës dhe ndjenja e pasigurisë të fëmijët.

Prindërimi është një mision i rëndësishëm, pasi prindërit janë mbrojtësit e parë dhe më të rëndësishëm të fëmijëve të tyre. Siç thekson Dr. Maria Montessori (1972), prindërit nuk duhet të shihen thjesht si sjellës të fëmijëve në jetë, por si kujdestarë dhe edukatorë të tyre. Edukimi dhe dashuria e tyre janë faktorët që i japin kuptim dhe e plotësojnë rolin e tyre si prindër. Vetëm përmes një përkushtimi të sinqertë dhe të vazhdueshëm, ata mund të ndihmojnë në formimin e një gjenerate të shëndetshme dhe të aftë për të ndërtuar një shoqëri më të mirë.

Në hulumtimet dhe studimet e sotme ka mendime, shkrime, publikime të shumta për martesat, familjet dhe stilet e prindërimit. ‘‘Pavarësisht se kush është përgjegjës për rritjen e fëmijës, studimet kanë treguar se ekzistojnë dallime thelbësore në stilet e prindërimit (Woolfolk, 2010). Një nga studiuesit e shumtë të kësaj fushe është edhe Diane Baumrindi, e cila gjatë viteve 1991, 1996 bëri kërkimet më të njohura deri më sot për stilet e prindërimit, të cilat kryesisht ishin të përqendruara në studimin e saj gjatësor të 100 fëmijëve parashkollorë shumica prej të cilëve i takonin shtresës së mesme euro-amerikanë.

Baumrindi theksoi 4 stile të prindërimit: prindërit me autoritet, prindërit autoritar, prindërit tolerant dhe prindërit refuzues.

***Prindërit me autoritet ‘‘(shumë dashuri, shumë kontroll) përcaktojnë qartazi kufijtë dhe presin që fëmijët e tyre të sillen si të pjekur (Woolfolk, 2010).***

Këta prindër me dashurinë që kanë shprehin edhe ngrohtësi me fëmijët e tyre, dëgjojnë shqetësimet e tyre, vendosin rregulla për të cilat edhe japin shpjegime dhe vendosin në mënyrë demokratike për zbatimin e tyre. Në këtë stil prindërimi ka më shumë orientim e udhëzim dhe fare pak ndëshkim e sidomos ndëshkime të rrepta. Prindërit i ndihmojnë, këshillojnë fëmijët që të mund ti parashikojnë pasojat e veprimeve të tyre dhe kështu hapësira për ndëshkim nga ana e tyre mbetet e pakët. ‘‘Me një bisedë në atë masë që qëndrimi i prindërve ofron dashuri dhe rregulla, fëmija do të formohet dhe do të jetojë me dashuri dhe me ekuilibër. Nëse nuk respektohet ky parim i lartë – dashuri dhe rregullatëherë fillojnë të ndodhin shtrembërime, përplasje, prishje të ekuilibrave si dhe debate me fjalë të shumta dhe boshe që as e ndriçojnë dhe as e ekuilibrojnë situatën (Sideris, 2010).

***Prindërit autoritarë (pak dashuri, shumë kontroll) paraqiten të ftohtë dhe kontrollues në ndërveprimet e tyre me fëmijët (Sideris, 2010).***

Prindërit autoritarë vendosin rregulla për të cilat nuk japin shpjegim të fëmijët e tyre, këta presin zbatim dhe nëse u kërkohet shpjegim nga ana e fëmijëve përdorin thjesht 16 autoritetin dhe përgjigjja e vetme është ‘‘Sepse unë thash kështu’’. Nëse nuk respektohet rregulli ose fjala rezulton me dënime të ashpra. ‘‘Sipas Baumrind, këta prindër janë të bindur dhe të orientuar drejt statusit dhe presin që urdhrat e tyre të zbatohen pa sqarim (Cherry, 2011). E gjithë kjo nuk nënkupton se mungon dashuria ndaj fëmijëve të tyre, edhe pse nuk flitet për emocione në këtë lloj stil prindërimi, ata thjesht nuk e shprehin dashurinë ndaj fëmijëve të tyre.

***Prindërit tolerantë (shumë dashuri, pak kontroll). Prindërit e tillë janë të mendimit se fëmijët nuk do të duhej të kenë shumë rregulla apo të kërkohet që të sillen si të pjekur, fëmijët thjesht janë fëmijë (Cherry, 2011).***

Mirëpo a është mënyra e duhur kjo karshi fëmijëve, rezultatet kanë treguar se fëmijët me prindër të tillë në të ardhmen kanë prirje të jenë impulsiv, shfaqje agresiviteti, pa qëllime të caktuara në jetë dhe kanë aftësi të ulët vetëkontrolli. Fëmijë të tillë kanë më pak gjasa të arrijnë suksese në jetë. Psikanalisti Nikos Sideris (2010), mbështet mendimin se një prindërim i tillë nuk është për tu lavdëruar, ai thekson se ‘‘në një shtëpi të gjithë janë të barabartë sa i takon dinjitetit të tyre, por njëkohësisht janë asimetrik sa u takon vetive, cilësive të tyre. Sipas tij është absurditet që të vegjël dhe të mëdhenj të mendojnë se çdonjëri është kapiteni brenda shtëpisë. Kur në një shtëpi nuk ka rregulla, atëherë të gjitha degradojnë, prandaj tolerance e tepërt, dhe mungesa e rregullit e disiplinës nga prindërit mund ta llastojë fëmijën deri në atë masë sa prindi duhet të bëjë çdo gjë që fëmija i tij kërkon. Në të ardhmen kjo jep rezultate jo të mira për jetën e tij, pavarësisht se këta prindër janë të ngrohtë e të kujdesshëm (Sideris, 2010).

***Prindërit refuzues (pak dashuri, pak kontroll), këta prindër duket sikur nuk kanë interes për komunikimin, bashkëpunimin apo mësimin e fëmijëve të tyre.***

Studimet e deritanishme tregojnë se: deri tani prindërimi i stilit autoritar, orientues dhe i kombinuar me ngrohtësi e mbështetje emocionale ka dhënë rezultatet më të mira në rritjen dhe edukimin e fëmijëve. Fëmijët të cilët janë rritur në praninë e prindërve të tillë dinë si të kenë prioritete, rregulla dhe synime të cilat do ti arrijnë në jetën e tyre (Sideris, 2010). Ndikimi i familjes në formimin e personalitetit të fëmijës është një fushë studimi mjaft e gjerë, shumë interesante dhe tejet sfiduese. Hulumtime të shumta, studime, artikuj dhe literatura në fushat e edukimit, psikologjisë, sociologjisë, kryesisht pra shkenca që studiojnë shoqërinë, teori të shumta që flasin për sjelljen dhe personalitetin e individin, japin përgjigje nga më të ndryshmet në lidhje këtë temë.

## 2.4 Studime të mëparshme dhe përfundimet kryesore

Studimet e mëparshme mbi ndikimin e ambientit familjar në formimin e personalitetit të fëmijës kanë nxjerrë në pah një lidhje të fortë mes kushteve ekonomike, socializimit në familje dhe zhvillimit emocional dhe intelektual të fëmijëve. Këto studime kanë trajtuar faktorët që kontribuojnë në rritjen dhe zhvillimin e fëmijëve, duke u fokusuar në rëndësinë e mbështetjes emocionale, edukative dhe sociale që ata marrin nga familja, si dhe ndikimin e kushteve socio-ekonomike.

Një studim i rëndësishëm i realizuar nga Conger et al. (1992) ka treguar se fëmijët që rriten në familje me kushte ekonomike të vështira janë më të prirur të përjetojnë stres dhe pasiguri, të cilat mund të ndikojnë në zhvillimin e personalitetit të tyre. Ky studim ka vërtetuar se stresi i shkaktuar nga varfëria mund të ndikojë në aftësinë e fëmijëve për të zhvilluar aftësi sociale dhe emocionale. Për më tepër, fëmijët që përjetojnë vështirësi ekonomike kanë më pak mundësi për të zhvilluar aftësi të shëndetshme sociale dhe intelektuale, pasi ata shpesh nuk kanë akses në mundësi edukative dhe aktivitete sociale që mund t'i ndihmojnë ata të zhvillohen si individë të suksesshëm (Conger et al., 1992).

Një tjetër studim i rëndësishëm nga McLoyd (1998) ka shqyrtuar ndikimin e kushteve socio-ekonomike në zhvillimin e fëmijëve dhe ka nxjerrë në pah se fëmijët që jetojnë në familje me kushte të vështira ekonomike shpesh janë më të ekspozuar ndaj stresit dhe pasigurisë, që mund të çojë në zhvillimin e problemeve emocionale dhe sociale. Ky studim gjithashtu ka treguar se këta fëmijë mund të përballen me sfida të mëdha në ndërveprimet e tyre shoqërore dhe mund të kenë vështirësi në përballimin e presioneve të jetës dhe zhvillimin e besimit të vetë-vlerësimit (McLoyd, 1998).

Një tjetër hulumtim i realizuar nga Evans (2004) ka shqyrtuar lidhjen mes kushteve të jetesës dhe zhvillimit të fëmijëve, duke theksuar se fëmijët që rriten në kushte të varfërisë shpesh përjetojnë nivele më të larta stresi dhe pasigurie, që mund të ndikojnë negativisht në zhvillimin e personalitetit të tyre. Sipas këtij studimi, fëmijët që përjetojnë kushte të vështira socio-ekonomike mund të kenë vështirësi në zhvillimin e aftësive të mendimit kritik dhe aftësive sociale, duke rezultuar në individë më të pasigurt dhe më të ndjeshëm ndaj problematikave të jetës (Evans, 2004).

### 3. METODOLOGJIA E HULUMTIMIT

Kjo temë diplome e nivelit Master është mbështetur në një hulumtim të thelluar, rishikim dhe analizë të rezultateve të studimeve të shumta për të ofruar një pasqyrë gjithëpërfshirëse mbi temën “Ndikimi i ambientit familjar në formimin e personalitetit të fëmijës”. Në këtë punim janë përdorur metoda të njohura shkencore, duke përfshirë një qasje mikse të hulumtimit teorik dhe metodën kualitative. Për referenca dhe citime, është përdorur stili APA i të shkruarit, duke siguruar standarde të larta akademike dhe koherencë në trajtimin e literaturës. Ky proces i hulumtimit përfshin planifikimin, grumbullimin, rishikimin, përzgjedhjen dhe analizimin e materialeve dhe dokumenteve të nevojshme, të cilat janë përpunuar në një dokument të strukturuar si është kjo temë diplome.

Përfundimet e këtij hulumtimi janë mbështetur në studime të shumta me karakter të ngjashëm, pra që lidhen me “Ndikimin i ambientit familjar në formimin e personalitetit të fëmijës”. Për të siguruar një kërkim të plotë dhe gjithëpërfshirës, janë përdorur burime primare, ku përfundimet janë nxjerrë nga analiza e të dhënave të mbledhura përmes një pyetësori të zhvilluar me disa respondent relevant. Për përpunimin dhe paraqitjen e rezultateve, janë përdorur grafikone dhe tabela të krijuara me ndihmën e platformës Microsoft Excel, duke mundësuar një analizë të detajuar dhe vizuale të të dhënave.

Gjithashtu, hulumtimi është mbështetur në burime sekondare, përfshirë publikime kombëtare dhe ndërkombëtare, revista me renome botërore, si dhe punime shkencore të publikuara në konferenca të ndryshme të karakterit të ngjashëm. Janë analizuar artikuj dhe dokumente që trajtojnë aspekte të ndryshme të temës, duke ofruar një bazë të gjerë për diskutim dhe nxjerrjen e përfundimeve. Kombinimi i burimeve dhe metodave të përdorura ka siguruar që ky punim të jetë një kontribut i vlefshëm në literaturën shkencore dhe praktikën edukative.

### **3.1 Qasja dhe metodat e përdorura**

Ky studim përdor një qasje të kombinuar (mixed-method), e cila përfshin si metoda sasiore ashtu edhe cilësore për të analizuar ndikimin e ambientit familjar në formimin e personalitetit të fëmijës. Qasja sasiore ndihmon në mbledhjen dhe analizimin e të dhënave numerike për të identifikuar modelet dhe lidhjet midis faktorëve të ndryshëm familjarë dhe personalitetit të fëmijës. Kjo arrihet përmes pyetësorëve të strukturuar që shpërndahen tek prindërit dhe mësuesit për të matur ndikimin e mjedisit familjar.

Në anën tjetër, qasja cilësore përdoret për të eksploruar më në thellësi përvojat, perceptimet dhe ndjenjat e fëmijëve dhe prindërve përmes intervistave gjysmë të strukturuar. Këto intervista ofrojnë një kuptim më të hollësishëm mbi mënyrën se si ambienti familjar ndikon në zhvillimin e personalitetit të fëmijës dhe si fëmijët përjetojnë faktorët e ndryshëm socialë dhe emocionalë brenda familjes. Për përpunimin dhe interpretimin e të dhënave, përdoret analiza statistikore për pjesën sasiore, ku të dhënat përpunohen duke përdorur platformën e Excel. Për të dhënat cilësore, përdoret analiza tematike, duke identifikuar modelet kryesore që dalin nga intervistat dhe përshkrimet narrative të pjesëmarrësve.

### **3.2 Mostra e hulumtimit**

Pyetësorët do të hartohen për nxënësit dhe prindërit e tre shkollave fillore të mesme të ulëta në Komunën e Gjilanit, dy prej tyre publike, Thimi Mitko dhe Abaz Ajeti, dhe shkolla private, Hello. Pyetësori përmban pyetje që masin faktorët emocional dhe socio-ekonomik që ndikojnë në zhvillimin e personalitetit të fëmijës. Numri i pritur i pjesëmarrësve në këtë studim është 50 nxënës dhe 50 prindër.

### **3.3 Instrumentet e mbledhjes së të dhënave**

Për realizimin e këtij hulumtimi është përdorur pyetësori si instrument kryesor për mbledhjen e të dhënave. Pyetësori është dizajnuar në mënyrë të tillë që të mbledhë informacione të detajuara mbi ndikimin e ambientit familjar në formimin e personalitetit të fëmijës.

### 3.4 Procesi i mbledhjes dhe analizës së të dhënave

Të dhënat janë mbledhur përmes një pyetësoi të strukturuar, i cili është shpërndarë tek nxënësit dhe prindërit e përzgjedhur nga tre shkolla fillore në komunën e Gjilanit: dy shkolla publike, "Thimi Mitko" dhe "Abaz Ajeti", dhe një shkollë private, "Hello". Pyetësoi përmbante pyetje të dizajnuara për të vlerësuar perceptimet e nxënësve mbi ndikimin e ambientit familjar në formimin e personalitetit të tyre.

Pas mbledhjes së të dhënave, analizimi është kryer përmes platformës Microsoft Excel. Fillimisht, të dhënat janë pastruar dhe organizuar për të siguruar saktësinë dhe qëndrueshmërinë e informacionit të marrë. Më pas, janë përdorur teknika statistikore për të përshkruar dhe interpretuar rezultatet, duke përfshirë:

- **Analizën përshkruese**, si përqindjet dhe mesataret, për të kuptuar shpërndarjen e përgjigjeve.
- **Tabela dhe grafikë vizual**, për të ilustruar rezultatet kryesore në mënyrë të qartë dhe të kuptueshme.
- **Analizën krahasuese**, nëse ka pasur ndryshime midis grupeve të ndryshme të nxënësve bazuar në faktorë si mosha apo gjinia.

Këto metoda kanë ndihmuar në identifikimin e modeleve dhe trendeve kryesore që lidhen me ndikimin e ambientit familjar në zhvillimin e personalitetit të fëmijës, duke ofruar një bazë të fortë për diskutimin e rezultateve dhe përfundimeve të studimit.

### 3.5 Pyetjet e hulumtimit dhe hipotezat

**Pyetja kryesore:** Si ndikon ambienti familjar në formimin e personalitetit të fëmijës?

Kjo pyetje synon të shqyrtojë faktorët kryesorë të ambientit familjar, duke përfshirë marrëdhëniet prind-fëmijë, stilin e prindërimit dhe faktorët socio-ekonomik, dhe ndikimin e tyre në formimin e personalitetit.

**Nën pyetjet ndihmëse:**

- Si ndihesh kur je në shtëpi me familjen tënde?
- A të ndihmojnë prindërit të ndihesh i/e sigurt dhe i/e besueshëm/e në vetvete?
- Si veprojnë prindërit kur bën diçka gabim?
- A të lejojnë prindërit të marrësh vendime të vogla për veten tënde?
- A të inkurajojnë prindërit që të kryesh detyrat e shkollës dhe punët e shtëpisë vetë?
- A ndikon gjendja ekonomike e familjes në gjërat që mund të bësh në shkollë dhe jashtë saj?
- Si veprojnë prindërit kur ke një problem ose ndihesh i/e mërzhitur?
- Si të ndihmojnë prindërit të mësosh rregullat dhe të sillesh mirë?
- A të ndihmon familja të ndihesh i/e rëndësishëm/e dhe i/e vlerësuar?
- Si e kalon kohën me familjen në shtëpi?
- Si të ndihmojnë prindërit të bëhesh më i/e pavarur?
- Cilat janë vlerat dhe parimet kryesore që përpiqeni t'i mësoni fëmijës suaj në familje?
- Si e ndihmoni fëmijën tuaj të zhvillojë vetëbesimin dhe pavarësinë?
- Si reagoni zakonisht kur fëmija juaj bën një gabim?
- Si e mbështetni fëmijën tuaj në shkollim dhe zhvillimin e tij akademik?

A mendoni se gjendja ekonomike e familjes ka ndikim në mundësitë dhe zhvillimin e fëmijës suaj?

### **Hipotezat e hulumtimit:**

- I. **H1:** Ambienti emocional i sigurt dhe mbështetës brenda familjes ndikon pozitivisht në formimin e personalitetit të fëmijës, duke zhvilluar ndjeshmëri dhe vetëbesim.
- II. **H2:** Stili autoritativ i prindërimit ndikon pozitivisht në formimin e një personaliteti të balancuar, të përgjegjshëm dhe vetë kontrolluar te fëmijët.
- III. **H3:** Faktorët socio-ekonomikë të familjes kanë ndikim në zhvillimin e pavarësisë dhe përgjegjësisë te fëmijët.

Këto pyetje dhe hipoteza janë të qarta, të realizueshme dhe të matshme përmes metodave statistikore dhe analizave që synojnë të verifikojnë ndikimet e ndryshme të ambientit familjar në zhvillimin e personalitetit të fëmijës.

### 3.6 Kufizimet e hulumtimit

Çdo hulumtim ka kufizimet e tij, dhe ky nuk bën përjashtim. Kufizimet kryesore të këtij hulumtimi përfshijnë:

1. **Përzgjedhja e mostrës** – Hulumtimi është kryer vetëm me një mostër prej 50 nxënësish nga tre shkolla fillore në komunën e Gjilanit. Kjo mund të ndikojë në përgjithësueshmërinë e rezultateve, pasi gjetjet mund të mos jenë përfaqësuese për të gjithë nxënësit e kësaj moshe në Kosovë.
2. **Përdorimi i vetëm një instrumenti për mbledhjen e të dhënave** – Ky studim është mbështetur vetëm në **pyetësor**, duke mos përfshirë metoda të tjera si intervistat apo vëzhgimet, të cilat mund të ofronin një kuptim më të thellë të ndikimit të ambientit familjar në formimin e personalitetit të fëmijës.
3. **Sinqeriteti i përgjigjeve të nxënësve** – Edhe pse pyetësori është krijuar për të qenë i qartë dhe i lehtë për t'u kuptuar, ekziston mundësia që disa nxënës të mos kenë dhënë përgjigje plotësisht të sakta ose të sinqerta për shkak të frikës, mungesës së kuptimit të pyetjeve ose dëshirës për t'iu përshtatur pritshmërive sociale.
4. **Faktorët e jashtëm që ndikojnë në rezultate** – Ambienti familjar është një koncept kompleks dhe ndikohet nga shumë faktorë të tjerë, si kultura, ekonomia dhe marrëdhëniet sociale. Ky studim nuk ka marrë parasysh të gjithë këta faktorë, gjë që mund të ndikojë në plotësinë e rezultateve.

Megjithatë, pavarësisht këtyre kufizimeve, rezultatet e këtij studimi japin një pasqyrë të rëndësishme mbi ndikimin e ambientit familjar në formimin e personalitetit të fëmijës dhe mund të shërbejnë si bazë për studime të mëtejshme në këtë fushë.

## 4. ANALIZA E TË DHËNAVE DHE REZULTATET

### 4.1 Prezantimi i rezultateve kryesore

#### Pyetje demografike

**Tabela I** – Gjinia e respondentëve

|                                | <b>Djalë</b> | <b>Vajzë</b> | <b>Total</b> |
|--------------------------------|--------------|--------------|--------------|
| <b>Cili është gjinia juaj?</b> | 21           | 29           | 50           |
| <b>Përqindja %</b>             | 42%          | 58%          | 100%         |

**Burimi:** Ahmeti. D., 2025

Tabela I paraqet shpërndarjen gjinore të respondentëve në këtë hulumtim, ku nga gjithsej 50 respondentë, 21 janë djem (42%), ndërsa 29 janë vajza (58%).

**Tabela II** – Moshë e respondentëve

|                      | <b>6-7 vjeç</b> | <b>8-9 vjeç</b> | <b>10-11 vjeç</b> | <b>Total</b> |
|----------------------|-----------------|-----------------|-------------------|--------------|
| <b>Sa vjeç/e je?</b> | 15              | 17              | 18                | 50           |
| <b>Përqindja %</b>   | 30%             | 34%             | 36%               | 100%         |

**Burimi:** Ahmeti. D., 2025

Tabela II paraqet shpërndarjen e respondentëve sipas grupmoshave 6-7 vjeç, 8-9 vjeç dhe 10-11 vjeç, me një total prej 50 respondentësh. Të dhënat tregojnë një ndarje relativisht të barabartë mes grupmoshave, megjithëse numri më i madh i respondentëve është në grupin 10-11 vjeç (36%), duke pasuar me 8-9 vjeç (34%) dhe më pak të përfaqësuar janë fëmijët e grupmoshës 6-7 vjeç (30%).

**Tabela III – Me kë jetoni në shtëpi?**

|                               | <b>Me të dy prindërit</b> | <b>Vetëm me njërin prind</b> | <b>Me gjyshërit apo familjarë të tjerë</b> | <b>Me dikë tjetër</b> | <b>Total</b> |
|-------------------------------|---------------------------|------------------------------|--------------------------------------------|-----------------------|--------------|
| <b>Me kë jeton në shtëpi?</b> | 38                        | 9                            | 2                                          | 1                     | 50           |
| <b>Përqindja %</b>            | 76%                       | 18%                          | 4%                                         | 2%                    | 100%         |


**Burimi:** Ahmeti. D., 2025

Tabela III paraqet shpërndarjen e respondentëve sipas strukturës familjare me të cilën ata jetojnë. Nga gjithsej 50 respondentë, ata janë ndarë në katër kategori kryesore: 38 fëmijë (76%) jetojnë me të dy prindërit, që përfaqëson shumicën dërrmuese të respondentëve, 9 fëmijë (18%) jetojnë vetëm me njërin prind (pra, ose me nënën ose me babanë), gjë që tregon një përfaqësim të konsiderueshëm të fëmijëve që rriten në familje të ndara ose me prindër të vetëm, 2 fëmijë (4%) jetojnë me gjyshërit apo familjarë të tjerë, duke reflektuar raste kur fëmijët janë nën kujdesin e të afërmeve, dhe 1 fëmijë (2%) jeton me dikë tjetër, që mund të përfshijë kujdestarë të tjerë ose situata të veçanta familjare.

Duke u bazuar në të dhënat e mësipërme, ato tregojnë se shumica e fëmijëve rriten në një ambient familjar tradicional, ku të dy prindërit janë të pranishëm. Përqindja 18% tregon se një numër i konsiderueshëm i fëmijëve rriten vetëm me një prind, që mund të ketë ndikim në zhvillimin e tyre social dhe emocional. Edhe pse një numër i vogël jetojnë me gjyshërit (4%), është e rëndësishme të analizohet se si kjo mund të ndikojë në formimin e personalitetit të tyre. Jetesa me dikë tjetër është një fenomen më pak i zakonshëm në këtë studim, por mund të jetë rezultat i faktorëve socio-ekonomikë, emigracionit ose kushteve të tjera familjare.

## Pyetje për të vlerësuar ndikimin e ambientit familjar

**Grafiku I** – Si ndihesh kur je në shtëpi me familjen tënde?




**Burimi:** Ahmeti. D., 2025

Grafiku I paraqet mënyrën se si fëmijët e përjetojnë ambientin familjar dhe ndjenjat e tyre kur janë në shtëpi me familjen. 29 fëmijë (58%) ndihen gjithmonë të lumtur dhe të sigurt në familjen e tyre. 18 fëmijë (36%) shprehin se shumicën e kohës ndihen mirë. 2 fëmijë (4%), deklarojnë se ndonjëherë ndihen të mërziur ose të pasigurt, duke sugjeruar që ata mund të kenë disa shqetësime emocionale ose dinamika familjare jo të qëndrueshme. Vetëm 1 fëmijë (2%) ndjen se shpesh është i/e mërziur ose i/e pasigurt.

Në përgjithësi, shumica e fëmijëve, pra 94% e respondentëve, ndihen mirë në shtëpi, qoftë gjithmonë ose shumicën e kohës, duke treguar se shumica e familjeve krijojnë një ambient të sigurt dhe të dashur për fëmijët. Konkretisht 6%, përjetojnë ndjenja të mërziutjes ose pasigurisë në familje.

**Grafiku II:** A të ndihmojnë prindërit të ndihesh i/e sigurt dhe i/e besueshëm/e në vetvete?




**Burimi:** Ahmeti. D., 2025

Grafiku II paraqet përgjigjet e respondentëve për pyetjen nëse prindërit i ndihmojnë ata të ndihen të sigurt dhe të besueshëm në vetvete. Nga gjithsej 50 fëmijë, 10 (20%) përgjigjen se prindërit gjithmonë i ndihmojnë të ndihen të sigurt dhe të besueshëm. Një pjesë tjetër, 13 fëmijë (26%), thonë se prindërit shpesh i ndihmojnë, duke sugjeruar se mbështetja prindërore është e pranishme, por jo gjithmonë në mënyrë të vazhdueshme. 25 fëmijë (50%) e pranojnë se ndonjëherë ndihmohen nga prindërit. Vetëm 2 fëmijë (4%) theksojnë se prindërit rrallë ose kurrë i ndihmojnë, çka mund të sugjerojë një mungesë të mbështetjes emocionale.

Më shumë se gjysma e fëmijëve (76%) përjetojnë një nivel të caktuar të mbështetjes prindërore, qoftë shpesh, gjithmonë ose ndonjëherë, që tregon se shumica e prindërve janë të angazhuar në rritjen e sigurisë dhe vetëbesimit të fëmijëve të tyre. Megjithatë, disa fëmijë përjetojnë mungesën e mbështetjes të nevojshme, çka mund të ndikojë në zhvillimin e besimit të tyre në vetvete dhe në marrëdhëniet e tyre sociale.

**Grafiku III:** Si veprojnë prindërit kur bën diçka gabim?




**Burimi:** Ahmeti. D., 2025

Grafiku III paraqet reagimin e prindërve kur fëmijët bëjnë diçka gabim dhe tregon se si ata ndërveprojnë me fëmijët në këto situata. Nga gjithsej 50 fëmijë, 20 prej tyre (40%) thonë se prindërit u shpjegojnë qetësisht pse është gabim dhe i ndihmojnë të përmirësohen. Ky rezultat tregon një qasje edukative dhe mbështetëse nga ana e prindërve. 12 fëmijë (24%) tregojnë se prindërit u tregojnë se është gabim, por ndonjëherë i ndëshkojnë. Kjo mund të sugjerojë një qasje më ndëshkuese që përdor edhe shpjegimin e gabimit, por përfshin gjithashtu ndëshkime. 2 (4%), deklarojnë se prindërit i ndëshkojnë menjëherë pa u shpjeguar asgjë.

Ky rezultat mund të reflektojë një qasje autoritare, ku fëmijët mund të ndihen të pasigurt dhe të frikësuar për të bërë gabimin. 16 fëmijë (32%) thonë se prindërit nuk u thonë asgjë kur bëjnë diçka gabim, duke sugjeruar një mungesë të komunikimit dhe udhëzimeve të nevojshme për të mësuar nga gabimet. (64%) përjetojnë një qasje edukative që përfshin shpjegimin dhe mbështetje për përmirësimin e gabimeve. (32%) ndodhen në një situatë ku mungon mbështetja e duhur dhe mund të përjetojnë ndëshkime që mund të ndikojnë në zhvillimin e tyre emocional dhe të ardhmen e tyre psikologjike.

**Grafiku IV:** A të lejojnë prindërit të marrësh vendime të vogla për veten tënde?




**Burimi:** Ahmeti. D., 2025

Grafiku IV tregon se si prindërit e lejojnë fëmijët të marrin vendime të vogla për veten e tyre. 38 fëmijë (76%) përgjigjen se shpesh i lejojnë të marrin vendime vetë, që tregon një nivel të konsiderueshëm të pavarësisë dhe besimit nga ana e prindërve. Ky rezultat është shumë pozitiv, pasi lejohet fëmijëve mundësia për të zhvilluar aftësitë e vendimmarrjes dhe të rrisin vetëbesimin në procesin e marrjes së vendimeve. 9 (18%), thonë se ndonjëherë i lejojnë të marrin vendime. Ky grup sugjeron se prindërit janë më të kujdesshëm dhe mund të jenë të nguruar të lejojnë fëmijët të marrin vendime në mënyrë të pavarur. 3 fëmijë (6%) shprehin se rrallë u lejohet të marrin vendime. Ky rezultat tregon se disa fëmijë mund të ndihen të kufizuar në mundësinë për të treguar pavarësinë dhe përgjegjësinë e tyre.

Një veçori e rëndësishme e kësaj tablele është se nuk ka fëmijë që thonë se prindërit kurrë nuk i lejojnë të marrin vendime. Kjo tregon se, në përgjithësi, prindërit janë të gatshëm të japin disa mundësi për fëmijët.

**Grafiku V:** A të inkurajojnë prindërit që të kryesh detyrat e shkollës dhe punët e shtëpisë vetë?




**Burimi:** Ahmeti. D., 2025

Grafiku V paraqet mënyrën se si prindërit inkurajojnë fëmijët për të kryer detyrat e shkollës dhe punët e shtëpisë vetë. 18 fëmijë (36%) thonë se gjithmonë i inkurajojnë të jenë të pavarur, duke sugjeruar një qasje edukative që nxjerr në pah rëndësinë e zhvillimit të pavarësisë dhe përgjegjësisë personale. 13 fëmijë (26%), thonë se shpesh i ndihmojnë, por i inkurajojnë të përpiqen vetë. Ky grup sugjeron një qasje më mbështetëse. Kjo tregon se prindërit janë të gatshëm të mbështesin fëmijët në procesin e mësimin dhe zhvillimit.

Për 4 fëmijë (8%), prindërit gjithmonë i ndihmojnë dhe rrallë i lejojnë të bëjnë diçka vetë, që tregon se këta fëmijë mund të ndihen më të mbështetur dhe të kontrolluar nga prindërit. Megjithatë, kjo mund të kufizojë zhvillimin e pavarësisë dhe mund të çojë në varësi të tepruar nga ndihma e prindërve. 15 fëmijë (30%) shprehin se prindërit nuk i kërkojnë të bëjnë gjëra vetë, çka mund të tregon një mungesë të inkurajimit për zhvillimin e pavarësisë dhe përfshirjes aktive të fëmijëve në kryerjen e detyrave të përditshme. Shumica e fëmijëve (62%) pranojnë se prindërit i inkurajojnë ose mbështesin të bëjnë detyrat e shkollës dhe punët e shtëpisë vetë, duke krijuar mundësi për zhvillimin e aftësive të pavarësisë dhe përgjegjësisë. (30%) ndoshta ndodhen në një mjedis ku nuk janë inkurajuar mjaftueshëm për të ndërmarrë detyrat e përditshme, gjë që mund të ndikojë në zhvillimin e aftësive të tyre të vetëmenaxhimit dhe pavarësisë.

**Grafiku VI:** A ndikon gjendja ekonomike e familjes në gjërat që mund të bësh në shkollë dhe jashtë saj?




**Burimi:** Ahmeti. D., 2025

Grafiku VI tregon se si gjendja ekonomike e familjes mund të ndikojë në mundësitë që kanë fëmijët për të kryer aktivitete në shkollë dhe jashtë saj. Sipas të dhënave, 4 fëmijë (8%) thonë se gjithmonë kanë mundësitë që u duhen, që sugjeron se këta fëmijë ndodhen në një situatë ku gjendja ekonomike e familjes nuk ka ndikim të rëndësishëm në mundësitë e tyre për të marrë pjesë në aktivitete, si në shkollë ashtu edhe jashtë saj.

25 fëmijë (50%), thonë se ndonjëherë gjendja ekonomike ndikon, por prindërit përpiqen të ndihmojnë. Ky rezultat sugjeron se, për shumicën e fëmijëve, gjendja ekonomike ka një ndikim të ndjeshëm, por prindërit përpiqen të mbështesin fëmijët për të mundësuar pjesëmarrjen në aktivitete. Për 14 fëmijë (28%), shpesh nuk mund të bëjnë gjërat që dëshirojnë për shkak të gjendjes ekonomike, duke treguar një ndikim më të theksuar të kushteve ekonomike në mundësitë e tyre për të marrë pjesë në aktivitete të ndryshme.

Në përfundim, 7 fëmijë (14%) thonë se gjithmonë e kanë të vështirë për shkak të kushteve ekonomike. 78% e fëmijëve raportojnë se gjendja ekonomike ka një ndikim të ndryshëm në mundësitë e tyre për të marrë pjesë në aktivitete, ndërsa 22% janë në gjendje të vazhdojnë normalisht pa ndikuar nga gjendja ekonomike. Kjo tregon se sfidat ekonomike janë të pranishme për shumicën e fëmijëve dhe se përpjekjet e prindërve për t'i mbështetur ato janë të rëndësishme për të ndihmuar në tejkalimin e këtyre vështirësive.

**Grafiku VII - Si veprojnë prindërit kur ke një problem ose ndihesh i/e mërzhitur?**




**Burimi:** Ahmeti. D., 2025

Grafiku VII tregon se si prindërit reagojnë kur fëmijët përballen me probleme ose ndihen të mërzhitur. 25 fëmijë (50%) thonë se prindërit i dëgjojnë dhe i ndihmojnë të gjejnë një zgjidhje kur kanë një problem ose janë të mërzhitur. Ky rezultat sugjeron se një pjesë e madhe e fëmijëve kanë një mbështetje aktive nga prindërit. 8 fëmijë (16%), thonë se prindërit i dëgjojnë, por nuk i ndihmojnë shumë. Ndonëse prindërit mund të jenë të gatshëm të dëgjojnë shqetësimet e fëmijëve të tyre, mund të mos ofrojnë mbështetje të mjaftueshme ose zgjidhje të qarta për problemet.

Për 5 fëmijë (10%), prindërit nuk i dëgjojnë gjithmonë kur kanë një problem. Ky grup mund të ndodhet në një situatë ku komunikimi me prindërit është i kufizuar ose nuk është i mjaftueshëm për t'i ndihmuar ata të kalojnë periudhat e vështira emocionale ose personale. Për 12 fëmijë (24%), nuk flasin me prindërit për problemet e tyre. Ky rezultat tregon se një pjesë e konsiderueshme e fëmijëve preferojnë të mos diskutojnë shqetësimet e tyre me prindërit, ndoshta për shkak të mungesës së besimit ose për shkak të një lidhjeje jo të fortë me ta.


**Grafiku VIII - Si të ndihmojnë prindërit të mësosh rregullat dhe të sillesh mirë?**



**Burimi:** Ahmeti. D., 2025

Grafiku VIII tregon se si prindërit ndihmojnë fëmijët të mësojnë rregullat dhe të silleshin mirë. Sipas të dhënave, 25 fëmijë (50%) thonë se prindërit u shpjegojnë qetësisht dhe u ndihmojnë të kuptojnë pse rregullat janë të rëndësishme. 17 fëmijë (34%), thonë se prindërit u tregojnë rregullat, por ndonjëherë nuk u shpjegojnë pse ato janë të rëndësishme. Kjo mund të tregojë një qasje më të thjeshtë në mësimin e rregullave, ku prindërit ndoshta përqendrohen më shumë në zbatueset e rregullave sesa në arsytimin e tyre. Për 5 fëmijë (10%), prindërit i detyrojnë të ndjekin rregullat pa i shpjeguar ato. Ky grup mund të ndodhet në një situatë ku rregullat janë të imponuara pa një mundësi për diskutim ose ku fëmijët nuk kanë mundësinë të kuptojnë arsyen për ato rregulla. Për 3 fëmijë (6%), prindërit nuk kërkojnë shumë nga ata që të ndjekin rregulla. Ky rezultat tregon një grup të vogël fëmijësh që mund të kenë më shumë liri dhe mundësi për të vepruar jashtë kufizimeve të rregullave të repta.

**Grafiku IX:** A të ndihmon familja të ndihesh i/e rëndësishëm/e dhe i/e vlerësuar?




**Burimi:** Ahmeti. D., 2025

Grafiku IX tregon se si familja kontribuon në ndihmën që fëmijët të ndihen të rëndësishëm dhe të vlerësuar. Sipas të dhënave, 33 fëmijë (66%) thonë se familja gjithmonë i bën të ndihen të rëndësishëm dhe të vlerësuar. Ky rezultat tregon se një shumicë e madhe e fëmijëve përjetojnë mbështetje të vazhdueshme dhe afirmuese nga familja e tyre, duke u ndjerë të rëndësishëm dhe të vlerësuar.

Një grup tjetër i fëmijëve, 12 prej tyre (24%), thonë se familja shpesh i bën të ndihen të rëndësishëm dhe të vlerësuar. Kjo sugjeron se, për këta fëmijë, ndihma dhe mbështetja nga familja është e pranishme, por ndoshta jo gjithmonë në mënyrë të rregullt. Megjithatë, edhe pse mund të ketë periudha pa mbështetje aktive, një shumicë e konsiderueshme e këtyre fëmijëve ende ndjehen të vlerësuar dhe të rëndësishëm gjatë një pjesë të kohës. Për 5 fëmijë (10%), familja ndonjëherë i bën të ndihen të rëndësishëm dhe të vlerësuar. Ky grup përjeton një mbështetje më të kufizuar nga familja, e cila ndodh në raste të rastësishme dhe ndoshta nuk është e vazhdueshme.

Të dhënat tregojnë një mbështetje të fortë dhe pozitive nga familja, duke kontribuar në ndihmën që fëmijët të zhvillojnë një ndjenjë të fortë vlerësimi dhe rëndësie për veten e tyre. Ky është një faktor kyç në ndihmën që fëmijët ndihen të mbështetur në zhvillimin e tyre emocional dhe social.

**Grafiku X-** Si e kalon kohën me familjen në shtëpi?




**Burimi:** Ahmeti. D., 2025

Grafiku X tregon se si fëmijët e kalojnë kohën me familjen në shtëpi. Sipas të dhënave, 28 fëmijë (56%) raportojnë se ata kalojnë kohë së bashku me familjen duke bërë aktivitete të ndryshme, si biseda, lojëra, lexime ose shikim filmash. Ky grup fëmijësh përjeton lidhje të forta dhe angazhim të drejtpërdrejtë me familjen, dhe kjo mund të ketë një ndikim pozitiv në zhvillimin e tyre emocional dhe social, duke ndihmuar në forcimin e lidhjeve dhe komunikimit brenda familjes.

13 fëmijë (26%) tregojnë se kalojnë pak kohë së bashku me familjen për shkak se prindërit janë të zënë. Kjo sugjeron se edhe pse aktivitetet e përbashkëta mund të ndodhin, ato janë të kufizuara për shkak të angazhimeve të prindërve, të cilët mund të kenë një kohë të kufizuar për t'u angazhuar në aktivitete familjare për shkak të detyrave ose punëve të tjera. 7 fëmijë (14%) thonë se nuk kalojnë shumë kohë me familjen. Ky grup mund të jetë ndikuar nga rrethana të ndryshme, si mospërputhje orari ose angazhime të tjera, që ndoshta nuk lejojnë që kohëzgjatja e aktiviteteve familjare të jetë e mjaftueshme për të krijuar lidhje të forta dhe për të kontribuar në zhvillimin e tyre emocional dhe social. Për 2 fëmijë (4%), secili anëtar i familjes merret me punët e veta dhe nuk ka shumë aktivitete së bashku. Ky është grupi më i vogël, dhe këta fëmijë mund të ndjehen më të izoluar nga aktivitetet familjare, çka mund të ndikojë në forcimin e lidhjeve familjare dhe mund të ndihmojë në zhvillimin e një ndjenje të përkatësisë brenda familjes.

**Grafiku XI - Si të ndihmojnë prindërit të bëhesh më i/e pavarur?**



**Burimi:** Ahmeti. D., 2025


Grafiku XI tregon se si prindërit ndihmojnë fëmijët të bëhen më të pavarur. Sipas të dhënave, 18 fëmijë (36%) raportojnë se prindërit u japin mundësi të bëjnë gjëra vetë, si të rregullojnë dhomën, të bëjnë detyrat, etj.

27 (54%), thonë se prindërit i ndihmojnë kur kanë nevojë, por gjithashtu i lënë të provojnë vetë. Ky grup ka një balancë mes mbështetjes dhe pavarësisë, dhe kjo është një mënyrë e shëndetshme për t'i mësuar fëmijët të marrin iniciativë dhe të zhvillojnë aftësi të reja në mënyrë të pavarur. Për 4 fëmijë (8%), prindërit i ndihmojnë shumë dhe nuk i lënë të bëjnë shumë gjëra vetë. Ky grup mund të jetë më i mbrojtur dhe ndoshta ka më pak mundësi për të zhvilluar aftësi të pavarura për shkak të mbikëqyrjes të madhe nga ana e prindërve. Ndërsa 1 fëmijë (2%) thotë se prindërit gjithmonë bëjnë gjithçka për të dhe nuk kërkojnë që të jenë të pavarur. Ky është grupi më i vogël.

Shumica e fëmijëve (90%) kanë mundësi të zhvillojnë pavarësinë përmes mundësive për të provuar gjëra vetë, ndërsa mbështetja e prindërve ndihmon në këtë proces, duke krijuar një ekuilibër të shëndetshëm mes udhëzimeve dhe mundësive për të vepruar vetë.

## Pyetjet dedikuar për prindërit

**Grafiku XII** - Cilat janë vlerat dhe parimet kryesore që përpiqeni t'i mësoni fëmijës suaj në familje?




**Burimi:** Ahmeti. D., 2025

Grafiku XII paraqet shpërndarjen e vlerave dhe parimeve që prindërit përpiqen t'i mësojnë fëmijëve të tyre. Nga të dhënat, vërehet se "Sjellja e mirë dhe morali" është vlera më e theksuar, e zgjedhur nga 32% e prindërve, duke treguar rëndësinë që ata i kushtojnë edukimit të fëmijëve për të pasur sjellje të përshtatshme dhe parime morale të forta. Pas saj, me 18%, vjen "Puna dhe përkushtimi në shkollë", që tregon se një pjesë e madhe e prindërve e konsiderojnë suksesin akademik si një element kyç në formimin e personalitetit të fëmijës. Një tjetër aspekt i rëndësishëm është "Vetëbesimi dhe iniciativa personale", me 16%, duke reflektuar dëshirën e prindërve për të rritur fëmijë të sigurt në vete dhe të aftë për të marrë vendime të pavarura. "Respekti për të tjerët" është zgjedhur nga 14% e prindërve, duke treguar se, megjithëse nuk është vlera më e theksuar. "Pavarësia dhe përgjegjësia" dhe "Bashkëpunimi dhe ndihma ndaj të tjerëve" janë zgjedhur nga 10% e prindërve secila, duke treguar se këto vlera kanë një rëndësi të moderuar, por jo aq të lartë sa vlerat e tjera më të theksuara.

Kjo reflekton një qasje të prindërve që kombinon aspektet morale me ato akademike dhe sociale, duke u përpjekur të krijojnë një ekuilibër në edukimin e fëmijëve të tyre.

**Grafiku XIII** - Si e ndihmoni fëmijën tuaj të zhvillojë vetëbesimin dhe pavarësinë?




**Burimi:** Ahmeti. D., 2025

Grafiku XIII paraqet mënyrat kryesore se si prindërit ndihmojnë fëmijët e tyre të zhvillojnë vetëbesimin dhe pavarësinë. Nga të dhënat, vërehet se metoda më e përdorur është "I jap mundësi të provojë gjëra të reja pa frikë nga dështimi", e zgjedhur nga 36% e prindërve. Kjo tregon se shumica e tyre besojnë se përvoja direkte dhe eksperimentimi janë mënyra efektive për të rritur ndjenjën e sigurisë dhe aftësinë për të marrë vendime në mënyrë të pavarur. Me 24%, qëndron "E mbështes me fjalë inkurajuese dhe vëmendje pozitive", duke treguar se një numër i konsiderueshëm prindërisht e shohin përkrahjen emocionale si një faktor kyç për zhvillimin e vetëbesimit të fëmijët e tyre. Ndërkohë, 22% e prindërve deklarojnë se "E inkurajoj të marrë vendime të vogla vetë", duke theksuar rëndësinë e ndërtimit të pavarësisë përmes vendimmarrjes së përditshme.

Një pjesë më e vogël e prindërve, 18%, kanë zgjedhur opsionin "E mbroj nga sfidat dhe mundohem t'i lehtësoj rrugën", duke treguar se disa ende ndihen të prirur ta mbrojnë fëmijën nga vështirësitë, ndoshta nga frika se ai mund të dështojë ose të përballet me vështirësi të mëdha. Megjithatë, fakti që ky opsion është më pak i zgjedhur krahasuar me të tjerët sugjeron se shumica e prindërve po i japin përparësi metodave që promovojnë vetëbesimin përmes përvojës, mbështetjes emocionale dhe vendimmarrjes, në vend që të mbrojnë fëmijën nga sfidat e jetës. Këto rezultate tregojnë një prirje pozitive drejt zhvillimit të pavarësisë dhe vetëbesimit të fëmijët, me një fokus të madh në inkurajimin e tyre për të provuar, për të marrë vendime dhe për të marrë mbështetje emocionale në këtë proces.

**Grafiku XIV** - Si reagoni zakonisht kur fëmija juaj bën një gabim?




**Burimi:** Ahmeti. D., 2025

Grafiku XIV paraqet mënyrat kryesore se si prindërit reagojnë kur fëmija i tyre bën një gabim. Shifrat tregojnë se qasja më e preferuar nga prindërit është diskutimi dhe ndihma për të nxjerrë mësim nga gabimi, e zgjedhur nga 38% e tyre. Kjo tregon një tendencë drejt edukimit përmes komunikimit dhe reflektimit, duke i dhënë fëmijës mundësinë të kuptojë dhe të mësojë nga përvojat e veta në mënyrë konstruktive. "Mundohem ta shmang konfliktin dhe e lë të kuptojë vetë gabimin", e zgjedhur nga 28% e prindërve. Kjo sugjeron se një pjesë e konsiderueshme e tyre preferojnë të mos ndërhyjnë drejtpërdrejt, por ta lejojnë fëmijën të nxjerrë vetë përfundimet nga veprimet e tij. Ndërkohë, 24% e prindërve vendosin një pasojë të drejtë dhe edukative për gabimin.

Opsioni më pak i zgjedhur është "E kritikoj dhe e ndëshkoj për të mos e përsëritur gabimin", me vetëm 10%. Kjo tregon se shumica e prindërve po i largohen metodave ndëshkuese dhe kritikës së ashpër, duke preferuar më shumë mënyrat që promovojnë reflektimin dhe të nxënit nga gabimet.


**Grafiku XV** - Si e mbështetni fëmijën tuaj në shkollim dhe zhvillimin e tij akademik?



**Burimi:** Ahmeti. D., 2025

Grafiku XV paraqet mënyrat kryesore se si prindërit mbështesin fëmijët e tyre në shkollim dhe zhvillimin akademik. Shifrat tregojnë se qasja më e zakonshme është sigurimi i mjeteve dhe kushteve të nevojshme për të mësuar, e zgjedhur nga 38% e prindërve. Pas kësaj, 28% e prindërve raportojnë se ndihmojnë fëmijët e tyre me detyrat e shtëpisë kur ata kanë nevojë, duke treguar përfshirje të drejtpërdrejtë në procesin e të nxënës. Ndërkohë, 24% e prindërve zgjedhin të motivojnë dhe inkurajojnë fëmijët e tyre të mësojnë vetë, duke theksuar rëndësinë e vetë-disiplinës dhe autonomisë në të nxënës. Opsioni më pak i zgjedhur është bashkëpunimi me mësuesit për të ndjekur përparimin e fëmijës, me vetëm 10%.

**Grafiku XVI - A mendoni se gjendja ekonomike e familjes ka ndikim në mundësitë dhe zhvillimin e fëmijës suaj?**




**Burimi:** Ahmeti. D., 2025

Grafiku XVI paraqet perceptimin e prindërve mbi ndikimin e gjendjes ekonomike të familjes në mundësitë dhe zhvillimin e fëmijës. Rezultatet tregojnë se shumica e prindërve (40%) besojnë se mbështetja dhe edukimi i fëmijës nuk varen vetëm nga aspekti financiar.

Megjithatë, një pjesë e konsiderueshme e prindërve (26%) mendojnë se gjendja ekonomike ndikon në burimet edukative që ata mund t'i ofrojnë fëmijës së tyre, si librat, mjetet mësimore apo qasja në teknologji dhe kurse shtesë. Po ashtu, 20% e prindërve besojnë se gjendja ekonomike e kufizon mundësinë e fëmijës për të marrë pjesë në aktivitete jashtëshkollore. Ndërkohë, 14% e prindërve nuk janë të sigurt për ndikimin e drejtpërdrejtë të gjendjes ekonomike në zhvillimin e fëmijës së tyre.

Edhe pse një numër i madh prindëresh besojnë se edukimi dhe mbështetja nuk varen ekskluzivisht nga aspekti financiar, një pjesë e konsiderueshme e tyre pranojnë se mundësitë për aktivitete jashtëshkollore dhe burimet edukative janë të ndikuara nga gjendja ekonomike e familjes. Kjo tregon se, pavarësisht përpjekjeve për të siguruar mbështetje emocionale dhe edukative, aspekti financiar mbetet një faktor i rëndësishëm në zhvillimin e fëmijës.

**Grafiku XVII - Si e ndihmoni fëmijën tuaj të krijojë marrëdhënie të shëndetshme me bashkëmoshatarët dhe njerëzit e tjerë jashtë familjes?**



**Burimi:** Ahmeti. D., 2025

Grafiku XVII paraqet mënyrat kryesore se si prindërit ndihmojnë fëmijët e tyre të krijojnë marrëdhënie të shëndetshme me bashkëmoshatarët dhe njerëzit jashtë familjes. Shifrat tregojnë se qasja më e zakonshme është mësimi i sjelljes dhe respektit për të tjerët, e zgjedhur nga 44% e prindërve.

Pas kësaj, 20% e prindërve mbështesin fëmijët duke biseduar me ta për përvojat e tyre me shokët dhe shoqet, duke theksuar rëndësinë e komunikimit dhe këshillimit për të menaxhuar marrëdhëniet. Ky qëndrim ndihmon fëmijët të kuptojnë më mirë se si të ndërveprojnë dhe të zgjidhin problemet me bashkëmoshatarët e tyre.

Ndërkohë, 18% e prindërve inkurajojnë fëmijët të shoqërohen dhe të marrin pjesë në aktivitete shoqërore, duke i ndihmuar ata të zhvillojnë aftësitë sociale dhe të bëhen më të hapur ndaj mundësive për miqësi dhe bashkëpunim. Po ashtu, një pjesë tjetër e prindërve (18%) preferojnë të mos ndërhyjnë shumë dhe të lejojnë fëmijën të zhvillojë marrëdhëniet vetë, duke theksuar rëndësinë e autonomisë dhe të mësuarit nga përvojat personale.

## 4.2 Diskutimi mbi rezultatet në raport me hipotezat

Në këtë seksion do të diskutojmë rezultatet e hulumtimit në lidhje me tre hipotezat e studimit, duke analizuar se si të dhënat mbështesin ose refuzojnë këto hipoteza.

- **Hipoteza 1 (H1): Ambienti emocional i sigurt dhe mbështetës brenda familjes ndikon pozitivisht në formimin e personalitetit të fëmijës, duke zhvilluar ndjeshmëri dhe vetëbesim.**

Rezultatet e pyetjeve që lidhen me ndjeshmërinë, vetëbesimin dhe mbështetjen emocionale nga familja mbështesin fuqishëm këtë hipotezë. Pjesa më e madhe e fëmijëve (58%) raportuan se ndihen të sigurt dhe të mbështetur emocionalisht në shtëpi. Po ashtu, 66% e fëmijëve thanë se familja i ndihmon të ndihen të rëndësishëm dhe të vlerësuar. Ky është një tregues i fortë i ndikimit pozitiv të një ambienti emocional të sigurt dhe mbështetës nga familja në zhvillimin e personalitetit të fëmijës. Në lidhje me ndërveprimin dhe sjelljen e fëmijëve, 76% e tyre raportuan se prindërit i ndihmojnë të jenë të sjellshëm dhe të respektojnë të tjerët, duke sugjeruar se një mjedis mbështetës dhe i sigurt emocionalisht ndihmon në zhvillimin e vetëbesimit dhe ndjeshmërisë së fëmijës. Prindërit që ofrojnë mbështetje emocionale dhe siguri krijojnë një bazë të shëndetshme për fëmijët që të rriten si individë të sigurt dhe të ndjeshëm ndaj nevojave të të tjerëve.

- **Hipoteza 2 (H2): Stili autoritativ i prindërimit ndikon pozitivisht në formimin e një personaliteti të balancuar, të përgjegjshëm dhe vetëkontrolluar te fëmijët.**

Rezultatet mbështesin fuqishëm këtë hipotezë, pasi shumë fëmijë raportuan se prindërit i inkurajojnë të marrin përgjegjësi dhe të bëjnë gjërat vetë. 54% e fëmijëve thanë se prindërit i ndihmojnë, por gjithashtu u japin mundësi të provojnë vetë, dhe 36% e fëmijëve thanë se prindërit u japin mundësi të bëjnë gjëra vetë, si detyrat e shkollës ose rregullimin e dhomës. Ky është një tregues i një stili prindëror autoritativ, ku prindërit janë mbështetës, por gjithashtu kërkojnë pavarësi dhe përgjegjësi nga fëmijët. Për më tepër, 50% e fëmijëve raportuan se prindërit i dëgjojnë dhe i ndihmojnë të gjejnë zgjidhje kur kanë probleme, dhe 76% e fëmijëve thanë se prindërit i ndihmojnë të ndihen të rëndësishëm dhe të vlerësuar. Kjo tregon se prindërit ndihmojnë fëmijët të zhvillojnë aftësi të rëndësishme si vetëkontrolli dhe përgjegjësia, duke u ofruar mundësitë për të mësuar dhe rritur vetëbesimin dhe aftësitë për të marrë vendime të pavarura.

- **Hipoteza 3 (H3): Faktorët socio-ekonomikë të familjes kanë ndikim në zhvillimin e pavarësisë dhe përgjegjësisë të fëmijët.**

Ky rezultat është më kompleks dhe sugjeron se faktorët socio-ekonomikë mund të kenë një ndikim të ndjeshëm në zhvillimin e pavarësisë dhe përgjegjësisë, por kjo mund të varirojë nga një individ në tjetrin. 50% e fëmijëve raportuan se gjendja ekonomike ndikon në mundësitë që kanë për të bërë aktivitete jashtë shkollës dhe jashtë shtëpisë, ndërsa 28% thanë se ndikon shpesh në gjërat që mund të bëjnë. Ky tregues sugjeron se për disa fëmijë, situata ekonomike mund të kufizojë mundësitë për të mësuar dhe zhvilluar pavarësinë. Megjithatë, 8% e fëmijëve thanë se gjendja ekonomike nuk ka ndonjë ndikim të dukshëm, duke sugjeruar se për disa individë, mbështetje tjetër përveç mbështetjes financiare është gjithashtu e rëndësishme për zhvillimin e pavarësisë. Ky rezultat tregon se, ndonëse faktorët socio-ekonomikë mund të ndikojnë në mundësitë që fëmijët kanë për aktivitete dhe për të zhvilluar aftësi të reja, ata nuk janë të vetmit faktorë që përcaktojnë pavarësinë dhe përgjegjësinë. Faktorët si mbështetja emocionale dhe stili i prindërimit janë gjithashtu të rëndësishëm në këtë proces.

Të dhënat e mbledhura mbështesin tri hipotezat e hulumtimit. Ambienti emocional i sigurt dhe mbështetës, stili autoritativ i prindërimit dhe faktorët socio-ekonomikë janë të gjithë faktorë të rëndësishëm që ndikojnë në formimin e personalitetit të fëmijës, zhvillimin e pavarësisë dhe përgjegjësisë, dhe ndjeshmërinë e vetëbesimit. Hulumtimi tregon se prindërit që ofrojnë një mbështetje të fortë emocionale dhe mundësi për pavarësi ndihmojnë fëmijët të rriten si individë të balancuar dhe të përgjegjshëm. Po ashtu, faktorët socio-ekonomikë kanë një ndikim, por mbështetje të tjera, si ajo emocionale dhe pedagogjike, janë gjithashtu të rëndësishme për zhvillimin e një personaliteti të shëndetshëm dhe të pavarur.

### 4.3 Krahاسimi i rezultateve me literaturën e shqyrtuar

Në këtë seksion, do të bëjmë një krahasim të rezultateve të hulumtimit tonë me literaturën e mëparshme, duke u fokusuar në lidhjen midis ambientit familjar, stilit të prindërimit dhe faktorëve socio-ekonomikë me zhvillimin e personalitetit të fëmijës dhe aftësive të tij për të qenë i/e pavarur dhe të përgjegjshëm.

Hipoteza e parë përpiket të vlerësojë ndikimin e një ambienti emocional të sigurt dhe mbështetës brenda familjes në formimin e personalitetit të fëmijës, duke zhvilluar ndjeshmërinë dhe vetëbesimin. Rezultatet e hulumtimit tonë treguan se një numër i konsiderueshëm i fëmijëve (58%) ndihen të sigurt dhe të mbështetur emocionalisht në shtëpi dhe 66% e fëmijëve ndihen të rëndësishëm dhe të vlerësuar nga familja. Këto gjetje janë në përputhje me shumë studime të mëparshme që kanë treguar se një mjedis emocional i mbështetur, ku fëmijët ndihen të sigurt dhe të vlerësuar, ka një ndikim të madh në zhvillimin e ndjeshmërisë dhe vetëbesimit të fëmijët. Për shembull, studime të ndryshme (Bowlby, 1988; Ainsworth, 1979) sugjerojnë se një lidhje e sigurt emocionale me prindërit ndihmon në zhvillimin e aftësive sociale dhe emocionale të fëmijët, si dhe kontribuon në rritjen e vetëbesimit dhe ndjeshmërisë. Kjo është mbështetur nga rezultatet tona, të cilat tregojnë se një ambient emocional i sigurt dhe mbështetës në familje është thelbësor për zhvillimin e këtyre aftësive.

Hipoteza e dytë nënkupton se stili autoritativ i prindërimit ndikon pozitivisht në formimin e një personaliteti të balancuar, të përgjegjshëm dhe vetëkontrolluar të fëmijët. Rezultatet tona mbështesin fuqishëm këtë hipotezë, pasi 54% e fëmijëve thanë se prindërit i ndihmojnë, por gjithashtu u japin mundësi për të provuar vetë, dhe 36% e fëmijëve thanë se prindërit i japin mundësi të bëjnë gjëra vetë. Ky gjetje është në përputhje me literaturën që tregon se prindërit autoritativë, të cilët janë mbështetës dhe udhëzues, por gjithashtu kërkojnë përgjegjësi dhe pavarësi, ndihmojnë në zhvillimin e aftësive të vetëkontrollit dhe përgjegjësisë të fëmijët. Nga literatura e prindërimit (Baumrind, 1966) e dimë se stili autoritativ karakterizohet nga një ekuilibër i mirë mes ndihmës dhe kërkesës për pavarësi dhe përgjegjësi. Kjo është e njëjtë me gjetjet tona, ku stili autoritativ i prindërimit është lidhur me aftësi të forta për vetëkontroll dhe përgjegjësi, si dhe me zhvillimin e personaliteteve të balancuara. Të dhënat tona tregojnë se prindërit që ushtrojnë një stil autoritativ, i ndihmojnë fëmijët të zhvillojnë vetëkontroll dhe përgjegjësi.

Hipoteza e tretë shqyrton ndikimin e faktorëve socio-ekonomikë në zhvillimin e pavarësisë dhe përgjegjësisë të fëmijët. Rezultatet tona sugjerojnë se gjendja ekonomike e familjes ndikon në mundësitë që kanë fëmijët për të angazhuar aktivitete jashtë shkollës, me 50% të fëmijëve që raportuan se gjendja ekonomike ndikon në mundësitë e tyre. Ky është një faktor i rëndësishëm që duhet marrë parasysh në zhvillimin e pavarësisë, pasi fëmijët që janë të kufizuar në mundësitë ekonomike mund të kenë më pak mundësi për të zhvilluar aftësi të reja dhe për t'u përfshirë në aktivitete që mund të kontribuojnë në zhvillimin e përgjegjësisë dhe pavarësisë.

Literatura ka treguar gjithashtu se faktorët socio-ekonomikë kanë një ndikim të madh në mundësitë që kanë fëmijët për të zhvilluar aftësitë e tyre dhe për të pasur mundësi për të mësuar (Elder, 1999). Fëmijët nga familje me kushte të vështira ekonomike mund të kenë më pak mundësi për aktivitete zhvillimore, si dhe për të mësuar aftësi të reja që kontribuojnë në rritjen e pavarësisë dhe përgjegjësisë. Megjithatë, literaturë e ndryshme (Masten, 2001) sugjeron gjithashtu se mbështetje të tjera, si mbështetja emocionale dhe pedagogjike, mund të kompensojnë ndikimet e gjendjes ekonomike dhe të ndihmojnë në zhvillimin e këtyre aftësive të fëmijët.

Rezultatet e hulumtimit tonë janë në përputhje me literaturën e mëparshme dhe mbështesin idenë se një ambient emocional i sigurt dhe mbështetës, stili autoritativ i prindërimit dhe faktorët socio-ekonomikë kanë ndikim të rëndësishëm në zhvillimin e personalitetit të fëmijës dhe aftësive të tij për të qenë i/e pavarur dhe të përgjegjshëm. Ndërsa faktorët socio-ekonomikë kanë një ndikim të rëndësishëm, mbështetje të tjera, si mbështetja emocionale dhe pedagogjike, janë gjithashtu thelbësore në këtë proces.

## 5. PËRFUNDIMET DHE REKOMANDIMET

### ❖ Përfundimet

Përfundimet e këtij hulumtimi janë të bazuara në analizën e të dhënave të mbledhura nga fëmijët e shkollave të ndryshme në Gjilan, dhe ato ofrojnë një pasqyrë të thelluar mbi ndikimin e faktorëve të ndryshëm në zhvillimin e personalitetit të fëmijëve. Hulumtimi u fokusua në tre aspekte kyçe: ambientin emocional të sigurt dhe mbështetës të familjes, stilin e prindërimit dhe ndikimin e faktorëve socio-ekonomikë. Çdo njëri nga këta faktorë ka një ndikim të rëndësishëm në zhvillimin e fëmijëve, dhe ky studim ka nxjerrë në pah se si ata kontribuojnë në formimin e personalitetit dhe aftësive të fëmijëve.

Një nga përfundimet më të rëndësishme të këtij studimi është se ambienti emocional i sigurt dhe mbështetës i familjes ka një ndikim pozitiv dhe të fuqishëm në zhvillimin e personalitetit të fëmijëve. Fëmijët që ndihen të vlerësuar dhe të mbrojtur nga prindërit dhe familja janë më të prirur të zhvillojnë vetëbesim, ndjeshmëri dhe aftësi për të menaxhuar emocionet e tyre. Kjo është në përputhje me teoritë psikologjike që theksojnë rëndësinë e një ambienti të sigurt emocional për zhvillimin e fëmijëve. Një mbështetje e tillë ndihmon në krijimin e një lidhjeje të fortë ndërmjet fëmijës dhe prindërve dhe i mundëson fëmijës të rritet në një mjedis që përmirëson aftësitë e tij sociale dhe emocionale. Në këtë hulumtim, shumica e fëmijëve kanë vlerësuar se familja e tyre është e përkushtuar në krijimin e një mjedisi mbështetës. Ky mbështetje është thelbësore për zhvillimin e aftësive të tilla si empatia dhe vetëbesimi, të cilat janë elemente të rëndësishme për formimin e një personaliteti të shëndetshëm dhe të balancuar.

Një tjetër përfundim i rëndësishëm është ndikimi i stilit autoritativ të prindërimit në zhvillimin e një personaliteti të balancuar dhe të përgjegjshëm. Stili autoritativ përfshin një ekuilibër të mirë mes kërkesave dhe mbështetjes emocionale. Ky stil prindërimi, i cili është i bazuar në ndihmë dhe udhëzim, por gjithashtu ofron një nivel të lartë të lirisë dhe pavarësisë për fëmijët, ka rezultuar se ndihmon në zhvillimin e aftësive të vetëkontrollit dhe përgjegjshmërisë. Fëmijët që rriten në një ambient ku prindërit u kërkojnë atyre të jenë të përgjegjshëm dhe të ndjekin rregulla të caktuara, por gjithashtu u ofrojnë mundësi për të zhvilluar mendimin kritik dhe të drejtat e tyre, kanë më shumë mundësi të zhvillojnë një personalitet të shëndetshëm dhe të balancuar.

Ky hulumtim ka treguar se stili autoritativ i prindërimit është më i lidhur me formimin e një personaliteti të shëndetshëm, ku fëmijët mund të ndihen të mbështetur, por gjithashtu të kenë mundësi të bëjnë vendime dhe të zhvillojnë aftësitë e tyre të menaxhimit të emocioneve dhe sjelljeve.

Një tjetër element kyç i këtij studimi është ndikimi i faktorëve socio-ekonomikë në zhvillimin e personalitetit të fëmijëve. Fëmijët që vijnë nga familje me kushte ekonomike të vështira shpesh përballen me barrierat që ndikojnë në zhvillimin e pavarësisë dhe përgjegjësisë. Ata mund të kenë më pak mundësi për të marrë pjesë në aktivitete edukative jashtë shkollës ose për të zhvilluar aftësi të tjera që ndihmojnë në formimin e personalitetit të tyre. Ky faktor socio-ekonomik është veçanërisht i rëndësishëm, pasi ndikon drejtpërdrejt në mundësitë që fëmijët kanë për t'u angazhuar në aktivitete që ndihmojnë në zhvillimin e aftësive të pavarësisë dhe përgjegjësisë. Mungesa e mundësive të tilla mund të kufizojë zhvillimin e fëmijëve dhe të kontribuoni në krijimin e një rruge më të vështirë për të arritur sukses në të ardhmen. Në këtë kuadër, ky studim ka evidentuar se familjet me kushte socio-ekonomike më të dobëta shpesh përballen me pengesa që u ndalojnë mundësitë për të siguruar zhvillimin e fëmijëve të tyre në nivelin e duhur. Përkundër kësaj, hulumtimi ka treguar gjithashtu se fëmijët nga këto familje, që kanë mundësi për mbështetje emocionale dhe mbikëqyrje të kujdesshme, mund të kompensojnë disa nga pengesat që krijohen nga faktorët socio-ekonomikë.

Një tjetër përfundim i rëndësishëm është ndikimi i kombinimit të këtyre faktorëve në zhvillimin e fëmijëve. Kjo është e rëndësishme për t'u kuptuar se çdo faktor ka një ndikim të ndryshëm, por kur këta faktorë bashkohen dhe përforcohen, ato kanë një ndikim më të fortë dhe më të qëndrueshëm. Fëmijët që kanë një mbështetje emocionale të fortë dhe rriten në një ambient autoritativ, kanë më shumë mundësi për të zhvilluar një personalitet të balancuar dhe të shëndetshëm, pavarësisht nga kushtet socio-ekonomike. Ky kombinim është kritik për të krijuar mundësi të barabarta për të gjithë fëmijët, pavarësisht nga rrethanat e tyre.

Përfundim i Përgjithshëm

Këta faktorë ndihmojnë në zhvillimin e aftësive të rëndësishme si vetëbesimi, përgjegjësia dhe pavarësia. Prindërit dhe familja kanë një rol kyç në zhvillimin e këtyre aftësive, dhe është e rëndësishme që ata të krijojnë kushte të tilla që ndihmojnë fëmijët të rriten në një mjedis të sigurt dhe mbështetës. Për më tepër, është e rëndësishme që politikatat dhe praktikatat që mbështesin familjet të jenë të fokusuara në përmirësimin e kushteve socio-ekonomike dhe në sigurimin e mundësive të barabarta për fëmijët për të zhvilluar aftësitë e tyre në mënyrë të shëndetshme. Ky hulumtim i ka ofruar një pasqyrë të qartë për rolin që ka mbështetja familjare në formimin e personalitetit të fëmijës dhe ka siguruar dëshmi për rëndësinë e krijimit të kushteve të barabarta për zhvillimin e fëmijëve.

Siç tregohet nga përgjigjet e prindërve, shumica prej tyre janë të angazhuar dhe të kujdesshëm për të ofruar mbështetje të ndryshme që i ndihmojnë fëmijët të rriten të sigurt, të pavarur dhe të aftë të ndërveprojnë shëndetshëm me bashkëmoshatarët dhe shoqërinë më të gjerë. Një nga aspekte më të rëndësishme që del nga hulumtimi është rëndësia që prindërit i japin zhvillimit të sjelljes dhe respektit për të tjerët. Shumica e prindërve theksojnë se një nga vlerat kryesore që ata përpiqen të mësojnë fëmijët e tyre është të jenë të sjellshëm dhe të respektojnë të tjerët. Kjo është një bazë e rëndësishme për të krijuar marrëdhënie të shëndetshme dhe për të ndihmuar fëmijët të zhvillojnë aftësi sociale që do t'i shërbejnë gjatë gjithë jetës. Mësimi i këtyre vlerave ka një ndikim të drejtpërdrejtë në mënyrën se si fëmijët ndërveprojnë me bashkëmoshatarët, duke i ndihmuar ata të krijojnë miqësi dhe të zhvillojnë aftësi të rëndësishme të bashkëpunimit dhe respektit.

Një tjetër aspekt i rëndësishëm është mbështetja që prindërit ofrojnë në zhvillimin e pavarësisë dhe vetëbesimit të fëmijëve të tyre. Përgjigjet e prindërve tregojnë një përpjekje të vazhdueshme për të inkurajuar fëmijët të marrin vendime të vogla vetë, të provojnë gjëra të reja dhe të zhvillojnë vetëbesim përmes inkurajimit dhe mbështetjes pozitive. Kjo qasje jo vetëm që ndihmon fëmijët të bëhen më të pavarur, por gjithashtu i bën ata të kuptojnë rëndësinë e përpjekjes dhe të mësuarit nga dështimet. Një pjesë e prindërve shprehen se ata preferojnë të mos ndërhyjnë shumë dhe të lënë fëmijët të zhvillojnë marrëdhëniet dhe aftësitë e tyre sociale vetë, që tregojnë besimin në aftësitë e tyre dhe nevojën për autonomi.

Në të njëjtën kohë, mbështetja e prindërve për zhvillimin akademik të fëmijëve është gjithashtu një prioritet i lartë. Prindërit kanë një rol aktiv në sigurimin e kushteve dhe mundësive për të mësuar, siç janë sigurimi i mjeteve dhe resurseve të nevojshme për të mësuar, si dhe motivimi për të marrë pjesë në detyrat e shkollës. Shumica e prindërve tregojnë se ata inkurajojnë fëmijët të zhvillojnë vetëdisiplinë dhe përkushtim për të arritur rezultate të mira në shkollë. Bashkëpunimi me mësuesit është gjithashtu një aspekt i rëndësishëm, pasi ndihmon prindërit të ndjekin përparimin akademik të fëmijëve të tyre dhe të ofrojnë mbështetje të përshtatshme.

Një tjetër faktor që është i rëndësishëm në zhvillimin e fëmijës është ndikimi i gjendjes ekonomike të familjes. Hulumtimi ka treguar se shumë prindër janë të vetëdijshëm për ndikimin që mund të ketë gjendja ekonomike në mundësitë dhe zhvillimin e fëmijëve të tyre. Megjithatë, një pjesë e madhe e prindërve besojnë se mbështetja dhe edukimi i fëmijës nuk varen vetëm nga aspekti financiar. Ata theksojnë rëndësinë e angazhimit emocional dhe të mbështetjes psikologjike, që është po aq e rëndësishme për zhvillimin e fëmijës sa çdo burim financiar.

Ky hulumtim tregon se prindërit janë thelbësorë në zhvillimin e fëmijëve të tyre, duke ofruar mbështetje dhe inkurajim për të rritur individë të pavarur, të sigurt dhe të aftë të ndërveprojnë në mënyrë shëndetshme me të tjerët. Prindërit e kuptojnë rëndësinë e vlerave të tilla si respekti, pavarësia, dhe përkushtimi në shkollë dhe janë të angazhuar në sigurimin e mundësive që do të ndihmojnë fëmijët e tyre të arrijnë potencialin e tyre të plotë. Angazhimi i vazhdueshëm i prindërve në këto fusha është një faktor kyç për zhvillimin e fëmijëve dhe për ndihmën që ata mund të ofrojnë në krijimin e një shoqërie të shëndetshme dhe të zhvilluar.

## **Rekomandimet**

Bazuar në gjetjet dhe përfundimet e këtij studimi, janë krijuar disa rekomandime për akterët kyç që kanë mundësinë të kontribuojnë në përmirësimin e kushteve për fëmijët dhe zhvillimin e personalitetit të tyre. Rekomandimet përfshijnë politikat dhe praktikatat për përmirësimin e kushteve të jetesës, mbështetjes emocionale dhe mundësive për zhvillim personal të fëmijëve.

### **Për prindërit**

- Të krijojnë një ambient emocional të sigurt dhe mbështetës, ku fëmijët ndihen të vlerësuar dhe të sigurt.
- Të angazhohen në aktivitete që përforcojnë vetëbesimin dhe ndjeshmërinë e fëmijëve, si aktivitete të përbashkëta, diskutime të hapura dhe mbështetje për realizimin e synimeve personale të fëmijëve.
- Të përdorin një stil autoritativ të prindërimit, ku mbështetja dhe kërkesat janë të balancuara, dhe të inkurajojnë zhvillimin e pavarësisë dhe përgjegjësisë.

### **Për mësuesit dhe shoqërinë civile**

- Të ofrojnë mundësi për aktivitete pas shkollës që ndihmojnë fëmijët të zhvillojnë aftësi sociale dhe emocionale.
- Të mbështesin prindërit dhe fëmijët në zhvillimin e aftësive për të qenë të pavarur dhe të përgjegjshëm, përmes programeve edukative dhe workshop-eve.

### **Për qeverinë dhe politikat publike**

- Qeveria duhet të ndërmarrë iniciativa për të përmirësuar kushtet socio-ekonomike të familjeve, duke ofruar mbështetje për ata që janë në nevojë. Kjo mund të ndihmojë në krijimin e mundësive të barabarta për zhvillimin e fëmijëve, pavarësisht nga sfidat ekonomike.
- Qeveria duhet të sigurojë mbështetje për prindërit, duke ofruar trajnime dhe mundësi për zhvillimin e aftësive të tyre në menaxhimin e fëmijëve dhe edukatën e tyre. Politikatat që mbështesin arsimimin dhe zhvillimin e prindërve mund të ndihmojnë në krijimin e një mjedisi të shëndetshëm për fëmijët.

## BIBLIOGRAFIA

- Bandura, A. (1977). *Social learning theory*. Prentice-Hall.
- Baumrind, D. (1966). Effects of authoritative parental control on child behavior. *Child Development*, 37(4), 887–907. <https://doi.org/10.2307/1126611>
- Baumrind, D. (1967). Childcare practices anteceding three patterns of preschool behavior. *Genetic Psychology Monographs*, 75(1), 43–88.
- Baumrind, D. (1991). The influence of parenting style on adolescent competence and substance use. *The Journal of Early Adolescence*, 11(1), 56-95.  
<https://doi.org/10.1177/02724316911111004>
- Belsky, J. (1984). The determinants of parenting: A process model. *Child Development*, 55(1), 83-96.
- Bowlby, J. (1969). *Attachment and loss: Volume 1. Attachment*. Basic Books.
- Bronfenbrenner, U. (1979). *The ecology of human development: Experiments by nature and design*. Harvard University Press.
- Collins, W. A., Maccoby, E. E., Steinberg, L., Hetherington, E. M., & Bornstein, M. H. (2000). Contemporary research on parenting: The case for nature and nurture. *American Psychologist*, 55(2), 218–232. <https://doi.org/10.1037/0003-066X.55.2.218>
- Conger, R. D., Conger, K. J., & Elder, G. H. (1992). *Linking economic hardship to marital quality and instability*. *Journal of Marriage and Family*, 54(3), 643-655.
- Conger, R. D., Ge, X., Elder, G. H., Lorenz, F. O., & Simons, R. L. (1994). Economic stress, coercive family process, and developmental problems of adolescents. *Child Development*, 65(2), 541-561. <https://doi.org/10.2307/1131401>

- Cummings, E. M., & Davies, P. T. (2000). *Effects of marital conflict on children: Recent advances and emerging themes in process-oriented research*. *Journal of Child Psychology and Psychiatry*, 41(1), 31-42.
- Darling, N., & Steinberg, L. (1993). Parenting style as context: An integrative model. *Psychological Bulletin*, 113(3), 487–496. <https://doi.org/10.1037/0033-2909.113.3.487>
- Epstein, J. L. (2001). *School, family, and community partnerships: Preparing educators and improving schools*. Westview Press.
- Erikson, E. H. (1950). *Childhood and society*. Norton & Company.
- Evans, G. W. (2004). The environment of childhood poverty. *American Psychologist*, 59(2), 77-92.
- Grolnick, W. S., & Ryan, R. M. (1989). Parent styles are associated with children's self-regulation and competence in school. *Journal of Educational Psychology*, 81(2), 143–154. <https://doi.org/10.1037/0022-0663.81.2.143>
- Harris, J. R. (2009). The nurture assumption: Why do children turn out the way they do.
- Harter, S. (2012). *The construction of the self: Developmental and sociocultural foundations*.
- Huston, A. C., et al. (2005). *Developmental contexts of early childhood*. Cambridge University Press.
- Lareau, A. (2003). *Unequal childhoods: Class, race, and family life*. University of California Press.
- Lewin, K. (1935). *A dynamic theory of personality*. McGraw-Hill.
- Maccoby, E. E., & Martin, J. A. (1983). Socialization in the context of the family: Parent-child interaction. In P. H. Mussen (Ed.), *Handbook of child psychology* (Vol. 4, pp. 1–101). Wiley.
- McLoyd, V. C. (1998). Socioeconomic disadvantages and child development. *American Psychologist*, 53(2), 185-204.

- Smetana, J. G. (1995). Parenting styles and conceptions of parental authority during adolescence. *Child Development*, 66(2), 299–316. <https://doi.org/10.2307/1131579>
- Sroufe, L. A., Egeland, B., Carlson, E., & Collins, W. A. (2005). *The development of the person: The Minnesota study of risk and adaptation from birth to adulthood*. Guilford Press.
- Steinberg, L., Lamborn, S. D., Darling, N., Mounts, N. S., & Dornbusch, S. M. (1994). Over-time changes in adjustment and competence among adolescents from authoritative, authoritarian, indulgent, and neglectful families. *Child Development*, 65(3), 754–770. <https://doi.org/10.2307/1131416>
- Vygotsky, L. S. (1978). *Mind in society: The development of higher psychological processes*. Harvard University Press.
- Wentzel, K. R., & Wigfield, A. (2007). *Handbook of motivation at school*. Routledge.
- Zeijl, E., et al. (2000). The role of parenting in adolescents' identity formation: A longitudinal study. *Journal of Youth and Adolescence*, 29(4), 325–341. <https://doi.org/10.1023/A:1005169005002>

## ANEKS

### Pyetje demografike:

1. Cili është gjinia juaj?
  - Djalë
  - Vajzë
2. Sa vjeç/e je?
  - 6-7 vjeç
  - 8-9 vjeç
  - 10-11 vjeç
3. Me kë jeton në shtëpi?
  - Me të dy prindërit
  - Vetëm me njërin prind
  - Me gjyshërit apo familjarë të tjerë
  - Me dikë tjetër

### Pyetje për të vlerësuar ndikimin e ambientit familjar tek fëmijët

4. Si ndihesh kur je në shtëpi me familjen tënde?
  - Gjithmonë i/e lumtur dhe i/e sigurt
  - Shumicën e kohës ndihem mirë
  - Ndonjëherë ndihem i/e mërzitur ose i/e pasigurt
  - Shpesh ndihem i/e mërzitur ose i/e pasigurt
5. A të ndihmojnë prindërit të ndihesh i/e sigurt dhe i/e besueshëm/e në vetvete?
  - Gjithmonë më ndihmojnë
  - Shpesh më ndihmojnë
  - Ndonjëherë më ndihmojnë
  - Rrallë ose kurrë më ndihmojnë

6. Si veprojnë prindërit kur bën diçka gabim?
- Më shpjegojnë qetësisht pse është gabim dhe më ndihmojnë të përmirësohem
  - Më tregojnë se është gabim, por ndonjëherë më ndëshkojnë
  - Më ndëshkojnë menjëherë pa më shpjeguar
  - Nuk më thonë asgjë edhe kur bëj diçka gabim
7. A të lejojnë prindërit të marrësh vendime të vogla për veten tënde?
- Po, shpesh më lejojnë të vendos vetë
  - Ndonjëherë më lejojnë
  - Rrallë më lejojnë
  - Asnjëherë nuk më lejojnë
8. A të inkurajojnë prindërit që të kryesh detyrat e shkollës dhe punët e shtëpisë vetë?
- Gjithmonë më inkurajojnë të jem i/e pavarur
  - Shpesh më ndihmojnë, por më inkurajojnë të përpiqem vetë
  - Më ndihmojnë gjithmonë dhe rrallë më lejojnë të bëj diçka vetë
  - Nuk më kërkojnë të bëj gjëra vetë
9. A ndikon gjendja ekonomike e familjes në gjërat që mund të bësh në shkollë dhe jashtë saj?
- Jo, gjithmonë kam mundësitë që më duhen
  - Ndonjëherë ndikon, por prindërit përpiqen të më ndihmojnë
  - Po, shpesh nuk mund të bëj gjërat që dua për shkak të gjendjes ekonomike
  - Po, gjithmonë e kam të vështirë për shkak të kushteve ekonomike
10. Si veprojnë prindërit kur ke një problem ose ndihesh i/e mërzhitur?
- Më dëgjojnë dhe më ndihmojnë të gjej një zgjidhje
  - Më dëgjojnë, por nuk më ndihmojnë shumë
  - Nuk më dëgjojnë gjithmonë kur kam një problem
  - Nuk flas me prindërit për problemet e mia

11. Si të ndihmojnë prindërit të mësosh rregullat dhe të sillesh mirë?

- Më shpjegojnë qetësisht dhe më ndihmojnë të kuptoj pse rregullat janë të rëndësishme
- Më tregojnë rregullat, por ndonjëherë nuk më shpjegojnë pse janë të rëndësishme
- Më detyrojnë të ndjek rregullat pa shpjegime
- Nuk më kërkojnë të ndjek shumë rregulla

12. A të ndihmon familja të ndihesh i/e rëndësishëm/e dhe i/e vlerësuar?

- Po, gjithmonë më bëjnë të ndihem i/e rëndësishëm/e
- Shpesh më bëjnë të ndihem i/e rëndësishëm/e
- Ndonjëherë më bëjnë të ndihem i/e rëndësishëm/e
- Rrallë ose kurrë nuk më bëjnë të ndihem i/e rëndësishëm/e

13. Si e kalon kohën me familjen në shtëpi?

- Bëjmë gjëra së bashku (bisedojmë, luajmë, lexojmë, shikojmë filma)
- Kalojmë pak kohë së bashku, por prindërit janë të zënë
- Nuk kaloj shumë kohë me familjen
- Secili merret me punët e veta dhe nuk kemi shumë aktivitete së bashku

14. Si të ndihmojnë prindërit të bëhesh më i/e pavarur?

- Më japin mundësi të bëj vetë gjëra si të rregulloj dhomën, të bëj detyrat, etj.
- Më ndihmojnë kur kam nevojë, por më lënë të provoj vetë
- Më ndihmojnë shumë dhe nuk më lënë të bëj shumë gjëra vetë
- Gjithmonë bëjnë gjithçka për mua dhe nuk më kërkojnë të jem i/e pavarur

## **Pyetjet dedikuar prindërve**

15. Cilat janë vlerat dhe parimet kryesore që përpiqeni t'i mësoni fëmijës suaj në familje?
- Respekti për të tjerët
  - Pavarësia dhe përgjegjësia
  - Bashkëpunimi dhe ndihma ndaj të tjerëve
  - Vetëbesimi dhe iniciativa personale
  - Puna dhe përkushtimi në shkollë
  - Sjellja e mirë dhe morali
16. Si e ndihmoni fëmijën tuaj të zhvillojë vetëbesimin dhe pavarësinë?
- E inkurajoj të marrë vendime të vogla vetë
  - I jap mundësi të provojë gjëra të reja pa frikë nga dështimi
  - E mbështes me fjalë inkurajuese dhe vëmendje pozitive
  - E mbroj nga sfidat dhe mundohem t'i lehtësoj rrugën
17. Si reagoni zakonisht kur fëmija juaj bën një gabim?
- Diskutoj me të për gabimin dhe ndihmoj që të mësojë nga ai
  - Vendos një pasojë të drejtë dhe edukative
  - E kritikoj dhe e ndëshkoj për të mos e përsëritur gabimin
  - Mundohem ta shmang konfliktin dhe e lë të kuptojë vetë gabimin
18. Si e mbështetni fëmijën tuaj në shkollim dhe zhvillimin e tij akademik?
- E ndihmoj me detyrat e shtëpisë kur ka nevojë
  - E motivoj dhe e inkurajoj të mësojë vetë
  - Bashkëpunoj me mësuesit për të ndjekur përparimin e tij
  - I siguroj mjetet dhe kushtet e nevojshme për të mësuar

19 . A mendoni se gjendja ekonomike e familjes ka ndikim në mundësitë dhe zhvillimin e fëmijës suaj?

- Po, sepse kufizon mundësinë për të marrë pjesë në aktivitete jashtëshkollore
- Po, sepse ndikon në burimet edukative që mund t'i ofrojmë
- Jo, sepse mbështetja dhe edukimi nuk varen vetëm nga aspekti financiar
- Nuk jam i/e sigurt

20. Si e ndihmoni fëmijën tuaj të krijojë marrëdhënie të shëndetshme me bashkëmoshatarët dhe njerëzit e tjerë jashtë familjes?

- E mësoj të jetë i/e sjellshëm/e dhe të respektojë të tjerët
- E inkurajoj të shoqërohet dhe të marrë pjesë në aktivitete shoqërore
- E mbështes duke biseduar me të për përvojat e tij/saj me shokët/shoqet
- Nuk ndërhyj shumë, e lë të zhvillojë marrëdhëniet vetë.